



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT NË KOSOVË NË 2017

Raporti për performancën e kompanive të licencuara të furnizimit me ujë, shërbimeve të ujërave të ndotura dhe furnizimit me shumicë të ujit të patrajtuar

Qershor 2018

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efçente të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik”

PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE	5
ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ARRU	6
1. HYRJE	7
2. ZHVILLIMET NË SEKTOR	8
3. PERFORMANCA INDIVIDUALE E KRU	10
3.1. FURNIZIM ME UJË	10
3.2. SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA	24
3.3. PERFORMANCA FINANCIARE E KRU	31
3.4. PERFORMANCA E PËRGJITHSHME E KRU	34
4. PERFORMANCA E SEKTORIT TË SHËRBIMEVE TË UJIT	41
4.1. UJI I PRODHUAR, SHITJET DHE UPF	41
4.2. MBULUESHMËRIA ME SHËRBIME	42
4.3. TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA, QARKULLIMI DHE PARAJA E GATSHME E ARKËTUAR.....	43
4.4. INVESIMET KAPITALE PËR FURNIZIM ME UJËSJELLËS DHE SHËRBIME TË UJËRAVE TË NDOTURA.....	44
5. PERFORMANCA E NPH "IBËR- LEPENCI"	46
6. AKTIVITETE E KKK.....	47
7. SFIDAT PËR TË ARDHMEN	48
SHTOJCA 1: KUALITETI DHE TË DHËNAT	51
SHTOJCA 2: DEFINICIONET DHE ARSYESHMËRIA.....	68
SHTOJCA 3: PASQYRAT PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE.....	75
SHTOJCA 4: PASQYRAT TARIFORE 2017 DHE (2018-2020)	78
SHTOJCA 5: PËRMBLEDHJE TREGUESISH	80
SHTOJCA 6 :TË DHËNA STATISTIKORE	81
SHTOJCA 7: DETAJET KONTAKTUESE	83
SHTOJCA 8: ZONAT E SHËRBIMIT TË KRU.....	84

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

<i>ARRU</i>	<i>Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit</i>
<i>ASK</i>	<i>Agjencioni i Statistikave të Kosovës</i>
<i>BPRR</i>	<i>Biznes Plane Rregullatore</i>
<i>BRRA</i>	<i>Baza Rregullatore e Aseteve</i>
<i>BD</i>	<i>Bordet e Drejtorëve</i>
<i>IKSHPK</i>	<i>Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës</i>
<i>IÇKK</i>	<i>Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë</i>
<i>KNMU</i>	<i>Këshillit Ndërmintor për Ujëra</i>
<i>KUR</i>	<i>Kompania Rajonale e Ujësjellësit</i>
<i>KKK</i>	<i>Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve</i>
<i>MMPH</i>	<i>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor</i>
<i>MZHE</i>	<i>Ministria e Zhvillimit Ekonomik</i>
<i>PMV</i>	<i>Plani i Monitorimit Vjetor</i>
<i>NJPM-NP</i>	<i>Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike</i>
<i>QU</i>	<i>Qendra e Ujit</i>
<i>UPF</i>	<i>Uji i Pa-Faturuar</i>
<i>UA</i>	<i>Udhëzimi Administrativ</i>
<i>UKRR</i>	<i>Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator</i>
<i>SCO</i>	<i>Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë</i>
<i>O.SH</i>	<i>Ofruesit e Shërbimeve</i>
<i>SIG</i>	<i>Sistemi Informativ Gjeografik</i>
<i>TKP</i>	<i>Treguesit Kyç të Performancës</i>

FJALA HYRËSE

Si çdo vit, edhe gjatë vitit 2017 përmes monitorimit të performancës së ofruesve të licencuar të shërbimeve të ujit, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) ka vlerësuar ecurinë dhe ngecjet e ofruesve të shërbimeve të ujit. Informatat, analizat, të dhënat e monitoruara dhe të audituara të cilat janë paraqitur në këtë raport pasqyrojnë gjendjen e sektorit dhe nivelin e shërbimeve që ofrohen.

Përmes monitorimit dhe vlerësimit të performancës përveç nxitjes së konkurrencës mes ofruesve të shërbimeve duke bërë vlerësimin krahasues, qëllimi kryesor i ARRU është të përmirësojë performancën dhe funksionimin eficient të ofruesve të shërbimeve. Edhe pse vit pas viti ofruesit e shërbimeve shënojnë përmirësime në fusha të caktuara, vazhdojnë akoma fusha në të cilat përmirësimet janë të pakënaqshme dhe përmirësimi i tyre kërkon mbështetjen e të gjitha palëve të interesit në sektorin e ujit.

Si rezultat i investimeve në rritjen e kapaciteteve prodhuese të ujit të pijshëm, furnizimi i rregullt i konsumatorëve është përmirësuar në vazhdimësi - në vitin 2017 në kuadër të sektorit furnizimi më ujë nga standardi i kërkuar prej 24 orësh ka arritur në 23.7orë.

Përmirësime janë shënuar edhe në mbulueshmërinë me shërbime të ujit (ujësjellës dhe ujëra të ndotura-kanalizim), megjithatë për të arritur standardet e kërkuara nevojitet angazhim i mëtejshëm me fokus në mbulueshmërinë me shërbime të kanalizimit. Trajtimi i ujërave të ndotura mbetet një ndër sfidat më të mëdha me të cilën sektori do të ballafaqohet në vitet në vijim. Bazuar në projeksionet e shpenzimeve, investimeve kapitale dhe normës së kthimit në kapital, ARRU përcakton tarifat përmes të cilave ofruesve të shpenzimeve u mundësohen investime me qëllim të përmirësimit të shërbimeve, mirëpo ka rezultuar që realizimi i investimeve të planifikuara në përgjithësi nuk është përmbushur. Me qëllim të sigurimit të realizimit të investimeve dhe një qëndrueshmërie afatgjate financiare, është e nevojshme që ofruesit e shërbimeve të përmirësojnë nivelin e arkëtimit. Përmirësimi i këtij treguesi kërkon angazhim përmes zhvillimit të planeve të qëndrueshme të veprimit, përmirësimit të leximit të rregullt të ujëmatësve, faturimit të rregullt, si dhe ndërmarrjen e masave operative dhe ligjore me kohë për konsumatorët e pandërgjegjshëm.

Uji i Pafaturuar (UPF) vazhdon të mbetet ndër shqetësimet kryesore të sektorit. Reduktimi i UPF është prioritet për të gjithë ofruesit e shërbimeve por edhe për palët tjera të interesit. Në këtë drejtim ofruesit e shërbimeve të mbështetur edhe nga një grup ndër-institucional kanë hartuar strategjitë dhe planet e veprimit për reduktimin e UPF.

Gjatë vlerësimit të performancës për vitin 2017, kemi bërë disa ndryshime në vlerësimin e përgjithshëm të performancës së ofruesve të shërbimeve duke shtuar dy tregues të ri: Ujin e pa faturuar dhe Raportimin Rregullator, si dhe ndryshimin e peshës së rëndësisë të treguesve në skemën e treguesve kyç të performancës. Me qëllim të sigurimit të të dhënave të sakta dhe të besueshme, ARRU mbështetur nga projekti i financuar nga SDC ka hartuar udhëzuesin për avancimin e sistemit të monitorimit në ARRU dhe në KRU dhe Modulën e auditimit / inspektimit vjetor. Me qëllim të avancimit, sigurimit të të dhënave të besueshme dhe lehtësisë të procesit të monitorimit është propozuar zhvillimi i sistemeve adekuate elektronike të ruajtjes dhe menaxhimit të informatave.

Përmirësimi i performancës së sektorit, siguri i shërbimeve sipas standardeve dhe qëndrueshmëria e ofruesve të shërbimeve është e lidhur ngushtë me angazhimin e të gjitha palëve të interesit, sidomos mbështetjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe donatorëve ndërkombëtar. ARRU ka qenë dhe gjithmonë do të jetë e gatshme që t'i mbështesë ofruesit e shërbimeve në përpjekjet e tyre për zhvillim dhe përmirësim të qëndrueshëm.

Falënderoj menaxhmentin dhe personelin e Kompanive Rajonale të Ujësjellësit për bashkëpunimin, si dhe stafin e ARRU për kontributin në hartimin e këtij raporti.

Me respekt

Raif Preteni, Drejtor i ARRU



ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ARRU

Mbështetur në Ligjin Nr. 05/L -042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, ARRU ka mandatin për të rregulluar sektorin dhe ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë.

ARRU këtë e bën duke:

- Licencuar ofruesit e shërbimeve dhe mbikëqyrur zbatimin e kushteve të përcaktuara me licencë të shërbimit;
- Përcaktuar tarifat e shërbimit për ofruesit e shërbimeve dhe duke siguruar që tarifat të jenë të drejta, të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve;
- Vendosur standarde të drejta të shërbimit dhe mbikëqyrur zbatimin tyre nga ofruesit e shërbimeve;
- Themeluar dhe mbështetur Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve në shtatë regjionet e Kosovës;
- Hartuar dhe miratuar: rregulloret, standardet dhe vendimet rregullatore në pajtim me autorizimet që ka në bazë të këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme;
- Inspektuar nivelin e përmbushjes së standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrur zbatimin e akteve ligjore të Autoritetit;
- Monitoruar dhe raportuar performancën e ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë, me qëllim të nxitjes së konkurrencës përmes krahasimit ("benchmarking") e cila si synim përfundimtarë ka përmirësimin e performancës së tyre.

Autoriteti mbledhë të dhëna dhe informata (raportet mujore dhe vjetore) sipas formateve dhe afateve të përcaktuara duke mos u kufizuar vetëm në të dhënat financiare, operative dhe të shërbimeve ndaj konsumatorëve, të cilat i nevojiten për të ushtruar përgjegjësitë e tij sipas këtij ligji apo të ligjeve tjera të aplikueshme në vend.

ARRU në vazhdimësi vit pas viti bën monitorimin e shërbimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri me objektivat tarifore dhe me nivelet e përcaktuara të standardeve të shërbimit. ARRU publikon raporte periodike dhe vjetore të performancës dhe raporte të tjera në të cilat shpalosen në hollësi vlerësimi i performancës së arritur në mënyrë që të:

- Sigurojë funksionimin eficient të ofruesve të shërbimeve dhe sektorit brenda standardeve minimale të shërbimit,
- Përcaktoj nivelin në të cilin ofruesit e shërbimeve i përmbushin objektivat e përcaktuara përmes procesit tarifor, si dhe
- Identifikojë veprimet korrigjuese që mund të jenë të nevojshme për të përmirësuar gjendjen.

Monitorimi i performancës dhe vlerësimi krahasues është një nga mekanizmat të cilat i përdorë ARRU për ti motivuar KRU, në mënyrë që ato të përmirësojnë performancën e tyre.

1. HYRJE

Në këtë raport detajohet performanca e shtatë Kompanive Rajonale të Ujësjellësit (KRU), të cilat ofrojnë shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, si dhe një ndërmarrje që ofron ujë me shumicë të patrajtuar për disa prej KRU.

KRU janë ndërmarrje publike të organizuara në baza rajonale si shoqëri aksionare (Sh. A.). Kanë një identitet të qartë ligjor dhe financiar dhe të cilat administrohen sipas parimeve të qeverisjes korporative. Qeveria e Kosovës është aksionare dhe mbikëqyrëse e afarizmit të tyre. Në aspektin e rregullimit ekonomik dhe kualitetit të shërbimeve ato i janë nënshtruar procesit rregullator të udhëhequr nga ARRU.

KRU ofrojnë shërbimet e tyre -furnizim me ujësjellës dhe shërbimet e ujërave të ndotura në 28 komuna të Kosovës. Raporti nuk përmban performancën e ofruesve të shërbimeve të cilat ofrojnë shërbime të tyre në pjesën veriore të Kosovës (Mitrovica e veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zevqan), meqenëse ende ato nuk janë licencuar dhe nënshtruar procesit rregullator. Po ashtu nuk janë përfshirë edhe Komunitet me vonë të themeluara si Shtërpce, Novobërdë, Partesh, Klokot, Ranillug dhe Hani i Elezit, të cilat janë parapar të integrohen në kompanitë rajonale përkatëse, pas rehabilitimit të infrastrukturës së tyre. Pritet se kjo do të ndodhë në fund të gjashtë muorit të parë të viti 2018.

Performanca e shërbimeve publike në këtë raport përshkruhet në bazë të krahasimit –vlerësimit të treguesve të performancës për vitin 2017 në raport me vitin paraprak 2016, arritjeve në përmbushjen e obligimeve tarifore dhe standardeve vendore të shërbimeve.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është pra, jo vetëm të promovoj vlerësimin e niveleve të cilësisë së shërbimit të të gjithë ofruesve të shërbimeve të ujit, por edhe për mbledhur, shpërndarë dhe publikuar informacione për performancën krahasuese në mes tyre. Përveç kësaj raporti rendit KRU në bazë të progresit dhe përmirësimit të performancës në ofrimin e shërbimeve të ujit, bazuar në metodologjinë, kriteret dhe treguesit kyç të performancës, të detajuar në planin e monitorimit vjetor.

Të dhënat dhe informacionet për përgatitjen e raportit janë mbledhur nga KRU përmes formateve të raporteve mujore dhe vjetore. Të dhënat e përdorura në këtë raport janë audituar dhe verifikuar nga ARRU sipas një formati të detajuar të auditimit/verifikimit, duke synuar konfirmimin e: saktësisë, besueshmërisë dhe konsistencës së të dhënave. Të dhënat përfundimisht janë pajtuar edhe nga O.SH të Ujit.

Disa të dhëna të raportuara i kemi shfrytëzuar edhe nga institucionet Qeveritare: IKSHPK (për vlerësimin e kualitetin e ujit) si dhe ASK (për vlerësimin e mbulueshmërisë së popullatës me shërbime dhe aspektet financiare).

Raporti përbëhet nga katër pjesë qendrore si në vijmë:

Performanca individuale e KRU, ofron të dhëna për performancën e KRU të ndarë në katër fusha të veçanta: furnizimi me ujësjellës, shërbimet për ujëra të ndotura, performancën financiare të KRU, si dhe vlerësimi i performancës së përgjithshme.

Performanca e sektorit të shërbimeve të ujit, jep të dhëna të performancës së përgjithshme të sektorit të shërbimeve të Ujësjellësit-Kanalizimit, për një periudhë pesë vjeçare (2013-2017), përmes disa treguesve kyç të performancës përfshirë: ujin e prodhuar, shitjet dhe UPF, mbulueshmërinë me shërbime, të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paranë e gatshme të arkëtuar, si dhe investimet kapitale për shërbime të furnizimit me ujësjellës dhe ujëra të ndotura.

Performanca e NHP "Ibër- Lepenc", ofron të dhëna dhe informacione për performancën e furnizuesit të vetëm të ujit me shumicë, NPH Ibër-Lepenci, si dhe

Aktivitetet e KKK, vlerëson performancën e tyre në trajtimin e ankesave të konsumatorëve në regionet e tyre respektive.

Shtojcat: japin të dhëna statistikore, tabelat me të dhënat e detajuara të performancës, pasqyrat përmbledhëse rregullore dhe tarifore, definicionet e të dhënave dhe treguesve, detajet e kontaktit dhe informacione të tjera të vlefshme.

2. ZHVILLIMET NË SEKTOR

2.1. Procesi tarifor 2018-2020

ARRU, ka përcaktuar tarifat e reja për shërbimet e ujësjellësit dhe shërbimet e ujërave të ndotura për tu zbatuar nga secila prej shtatë Kompanive Rajonale të Ujësjellësit (KRU) për tre vitet e ardhshme, 2018-2020. Ngarkesat tarifore janë bazuar mbi projeksionet e shpenzimeve, investimeve kapitale dhe një norme për kthim në kapital.

Kompanitë e ujit kanë ofruar të dhëna në planet e tyre të biznesit mbi të cilat ne jemi bazuar për vendimet tona tarifore dhe nga përvoja e mëhershme jemi treguar më realist në lidhje me pritjet tona sa i përket përmirësimeve të efikasitetit. Si pjesë e procesit të përcaktimit të këtyre tarifave, ARRU është konsultuar me Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve të cilët përfaqësojnë interesat e konsumatorëve, po ashtu ka pasur debate publike me qytetarë, si dhe janë konsultuar edhe palët e interesit.

Ne kemi vërejtur se kërkesat e konsumatorëve për një shërbim më të mirë janë rritur dhe si rezultat i kësaj ne jemi të sigurt se konsumatorët do të jenë të gatshëm të paguajnë më shumë për të siguruar përmirësime në shërbimin e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura që ata marrin.

ARRU ka vendosur të reduktoj shkallën e ndër-subvencionimit për tarifat volumetrike të ujit. ARRU njehërit ka reduktuar tarifat fikse mujore për konsumatorët jo shtëpiak (Institucione, Biznese dhe Industri) nga 3 euro në 2 euro në muaj, derisa tarifat fikse për konsumatorët shtëpiak kanë mbetur të njëjta dhe atë në vlerë prej 1 euro në muaj. Si rezultat i zvogëlimit të ndër-subvencionimit tek të gjitha KRU-të kemi zvogëlim të tarifave volumetrike për shërbimet e ujësjellësit, për të gjithë konsumatorët jo shtëpiak për tri vitet e ardhshme të procesit tarifor.

Duhet theksuar se gjatë tri viteve të fundit nuk ka pasur ngritje të tarifave në asnjë KRU. Rritja e ekuilibruar e tarifave për konsumatorët shtëpiak bazohet në zvogëlimin e shkallës së ndër-subvencionimit ndërmjet konsumatorëve shtëpiak dhe jo shtëpiak, si dhe në rritjen e prodhimit të ujit nga KRU, në funksion të zgjerimit të shërbimeve dhe rritjes së shkallës së mbulimit me shërbime të ujit.

Për të siguruar furnizim 24 orë me ujë KRU 'Prishtina' ka ndërtuar fabrikën për përpunim të ujit, dhe duke marrë parasysh atë se fabrika e ujit në Shkabaj e ndërtuar nga KRU 'Prishtina', përveç donacioneve, një pjesë e madhe është financuar nga kredia, rreth 22 mil. euro, e cila shumë rrjedhimisht ndikon në rritjen e tarifave të ujit për konsumatorët shtëpiak në regjionin e Prishtinës.

Gjatë procesit tarifor 2018-2020 pritet të vihen në funksion impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura në regjionin e Prizrenit dhe Gjakovës. Për të mbuluar shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes, pritet të ketë rritje të tarifave volumetrike të ujërave të ndotura për vitet 2019 dhe 2020 (varësisht prej kohës kur aktivizohet impianti për trajtimin e ujërave të ndotura).

Në funksion të reduktimit të humbjeve të ujit ARRU ka parashikuar dhe ka aprovuar reduktimin e humbjeve të ujit për 2% në vit, për tri vitet e procesit tarifor (në total 6%).

ARRU vit pas viti publikon raportin vjetor të performancës së kompanive të licencuara për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe shërbimeve për ujëra të ndotura, dhe KRU gjatë këtyre viteve kishin realizuar vetëm një pjesë të vogël të investimeve të planifikuara për përmirësimin e shërbimeve. Gjatë tre viteve të ardhshme kjo duhet të përmirësohet. Ne kemi lejuar mundësi realiste për investime por në mënyrë që këto investime të financohen është e domosdoshme që KRU të përmirësojnë arkëtimin e të ardhurave nga konsumatorët. Pa këto mjete financiare KRU janë të pafuqishme për të përmbushur nivelin e tyre të shërbimit dhe detyrimet e investimeve. Konsumatorët po ashtu duhet të jenë më të ndërgjegjshëm se faturat duhet paguar. ARRU është duke punuar me kompanitë për të siguruar që politikat dhe praktikët e drejta do të

zbatohen nëse vjen deri te ç'kyçja nga shërbimet e ujësjellësit. Sa i përket rasteve të konsumatorëve që kanë vërtetë vështirësi për të paguar, ata duhet të ndihmohen nga institucionet përgjegjëse –Qeveria e Kosovës.

Tarifat në Kosovë janë ende shumë më të vogla se ato në vendet tjera Evropiane, ku nivelet e shërbimit janë shumë më të larta. Së shpejti presim që tarifat do të rriten ndjeshëm, kjo veçanërisht vlen për shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura. Investimet në këtë drejtim kanë filluar dhe ato do të jenë të konsiderueshme, meqenëse edhe kërkesat për përmbushjen e kriterëve mjedisorë të BE janë te mëdha.

2.2. Ligji për faljen e borxheve

Në gusht të viti 2015 hyri në fuqi Ligji për Faljen e Borxheve. Sipas këtij Ligji qytetarët e Kosovës mund ta shlyenin borxhin deri në fund të vitit 2008 me kusht që nga viti 2009 deri në fund të vitit 2014 t'i kryenin obligimet e tyre. Fillimisht periudha për shlyerjen e borxheve ka zgjatur deri në Gusht të vitit 2016. Pastaj i njëjti ligj është ndryshuar dhe plotësuar në Janar të vitit 2017, për të vazhduar periudhën e faljes së borxheve deri me 1 Shtator të po këtij viti, me qëllim që sa më shumë qytetarë/konsumatorë apo biznese të kenë përfitime nga ky ligj. Përfituesit e faljes së borxhit kanë qenë edhe konsumatorët që kanë pasur shuma të borxheve publike të pa shlyera ndaj Kompanive Rajonale të Ujësjellësit. Me këtë ligj Qeveria synonte të stimulojë konsumatorët për pagesat e tyre për shërbimet e ofruara në vitet që pasojnë.

Falja e borxheve publike nuk është një praktikë e re në sektorin e shërbimeve të uji. Në fakt rregullorja e më herëshme 2004/49 e UNMIK-ut e hyrë në fuqi 26 nëntor 2004 mbi veprimtarin e ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave, pati lejuar faljen e borxheve të vjetra brenda gjashtë muajve të parë të hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje. Falja e borxheve të vjetra pati përfshirë borxhet e konsumatorëve deri me 31 dhjetor 2000, në nivelin 100% për të gjitha kategoritë e konsumatorëve, përderisa ka vazhduar periudhën e faljes për kategorinë e konsumatorëve të amvisërisë dhe atyre komercial-industrial, deri në fund të vitit 2001 në nivelin 50%. Kjo falje e borxheve po ashtu ka qenë e kushtëzuar me nënshkrimin e kontratës për shërbime, si dhe pagesën e pjesës tjetër të borxhit të mbetur apo hyrjen dhe respektimin e marrëveshjes për pagesën, i cili nuk ka mundur të falet sipas rregullores. Ndonëse ka pasur një zbatim nga disa prej KRU, nuk ka pasur ndonjë informacion të mëtejshëm për nivelin e zbatimit, si dhe efektet e prodhuara prej zbatimit të saj as nga Rregullatori, Qeveria apo edhe vetë KRU.

Zbatimi i Ligjit mbi faljen e borxheve publike në performancën e kompanive të ujit në vitin 2016 në raport me vitin 2015 ka pasur ndikim direkt në mbledhjen e borxheve të mëhershme, të cilët konsumatorët i kishin ndaj KRU. Shkalla e arkëtimit në vitin 2016 u ngrit në 86% nga 74% sa ishte në vitin 2015, dhe u karakterizua me një normë më të lartë të përmirësimit prej 12%, ndërsa në vlerë monetare përmirësimi i arkëtimit ishte mbi 4.6 mil.€ me tepër. Trendi i përmirësimit të shkallës së arkëtimit ka vazhduar edhe në vitin 2017, ndonëse norma e përmirësimit ishte më e ulët se në vitin 2016 për 2%. Në total borxhi i konsumatorëve ndaj të gjitha KRU (në përjashtim të KRU "Hidrodrini")¹ ka qenë mbi 108.1 mil. €. Nga kjo vlerë janë falur 19.1 mil. € apo 18%. Janë programuar 13.1 mil. €, apo norma e riprogramuar në raport me borxhin total ka qenë 12%, përderisa vlera e keshit të realizuar nga borxhi ishte 5,2 mil. €.

Është evidente përmirësimi i bazës financiare të KRU nga ndikimi i zbatimit të shlyerjes së borxheve financiare, njëjtë sikurse të shkalla e inkasimit, ndikimi i pritshëm ishte shënuar edhe tek profitabilitetit, trendi ishte pozitiv për 0.7%, në vitin 2016/2015. Megjithatë trendin më të lartë në këtë tregues me 2.67% e shofim në vitin 2017 në raport me vitin 2016, pasi që shpenzimet totale operative sipas kontabilitetit rregullator, janë me të ulëta si shkak i zvogëlimit të borxhit i bartur nga viti 2016. Si rezultat përfundimtar të gjitha KRU, vitin 2017 e kanë përmbyllur me një qendrueshmëri shumë më të lartë financiare, e që me siguri do të reflektoj edhe më tej në ngritjen e standardeve të shërbimit, me përfitime për të gjithë konsumatorët e tyre.

¹ KRU Hidrodrini, nuk ka ofruar informacione

3. PERFORMANCA INDIVIDUALE E KRU

Kjo pjesë e raportit fokusohet në treguesit kryesor të performancës që ndikojnë drejtpërdrejtë në shërbimet e ofruara ndaj konsumatorëve. Një pasqyrë më e hollësishme e performancës që përfshinë më shumë tregues është paraqitur në SHTOJCËN 1, të këtij raporti.

3.1. FURNIZIM ME UJË

Në këtë nën- pjesë të raportit analizohet performanca individuale e shtatë KRU, në lidhje shërbimit e furnizimit me ujë në vitin 2017 dhe krahason performancën me vitin paraprak 2016 dhe po ashtu kundrejt cageve / pritjeve që kanë qenë të përfshira në rishikimin tarifar 2017. Ne e kemi ndarë këtë analizë në tri nën-pjesë kryesore: jo-financiare (teknike), jo-financiare (komerciale) dhe financiare, në disa prej treguesve të rëndësishëm.

3.1.1. Jo-financiare (teknike)

Performanca jo financiare (teknike) fokusohet mbi aspektet teknike të furnizimit me ujë të tilla si cilësia e shërbimit dhe aspektet operative me një fokusim në ata tregues që ndikojnë drejtpërdrejtë në shërbimin e konsumatorëve - cilësia e ujit, presioni i ujit, vazhdimësia e furnizimit me ujësjellës, plasaritjet e gypave dhe uji i pa-faturuar.

Cilësia e ujit

Kualiteti i ujit është një standard shumë i rëndësishëm për shkak të ndikimit shëndetësor që ka tek konsumatorët. Cilësia e ujit i referohet karakteristikave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike, në raport me një sërë standardesh vendore në kuadër të të cilave mund të vlerësohet pajtueshmëria. Analiza e kualitetit të ujit në këtë raport është bërë në bazë të raporteve të dërguara nga IKSHPK, e cila edhe e ka përgjegjësinë e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë së ujit të furnizuar nga KRU.




Fig.1. % e testeve të kaluara

Në fig.1, është paraqitur përqindja e rezultateve e mostrave të testuar që kalojnë rezultatet e parapara për cilësinë, mikrobiologjike dhe fiziko - kimike në periudhën raportuese. Në total janë 8,180 mostra të analizuar nga IKSHPK në vitin 2017, prej të cilave 5,858 i janë nënshtruar testimeve mikrobiologjike, përderisa dështimet janë evidentuar vetëm 5 mostra apo 0.1% prej tyre.

Në aspektet fiziko-kimike janë analizuar gjithsejtë 2,322 mostra dhe vetëm 10 prej tyre apo 0.4%, nuk i kanë përmbushur vlerat parametrike të standardeve.

Tab.1. Norma (%) e testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike në përputhje me standardet e cilësisë së ujit dhe sipas KRU

KRU	Prishtina	Hidroregjioni Jugor	Hidrodrini	Mitrovica	Gjakova	Bifurkacioni	Hidromorava	Mesatare e sektorit
Mikrobiologjike	99.9%	100%	100%	100%	100%	99.4%	99.5%	99.9%
Fiziko-Kimike	99.1%	100%	100%	100%	100%	95.9%	100%	99.6%
Mesatarja për KRU	99.7%	100%	100%	100%	100%	98.4%	99.7%	99.8%

Testimet zbuluan se pajtueshmëria e përgjithshme në shtate KRU ishte 99.8% në përputhje me vlerat parametrike të standardeve vendore, kjo do të thotë se cilësia e ujit të furnizuar nga KRU është e mirë dhe me përmirësim të mëtejshëm të cilësisë së ujit në vitin 2017/2016.

Deri me tani vetëm dy KRU 'Prishtina' dhe 'Gjakova' kanë mundur të bëjnë monitorimin internë në laboratorët e tyre të akredituara, ndërsa pjesa tjetër e KRU këtë shërbim e kanë të kontraktuar me IKSHPK. Kompanitë e tjera duhet të vazhdojnë me procesin e akreditimit të laboratorëve dhe pajisjen e tyre me staf dhe aparatura të domosdoshme-nevojshme për të realizuar vet monitorimin intern të cilësisë së ujit, në përputhje me UA 16/2012.

Presioni i Ujit

Është një tregues kyç i performancës dhe standard i rëndësishëm i shërbimit dhe paraqet normën mesatare të pronave të shërbyera gjatë periudhës raportuese të cilat kanë ndodhur në zonat e KRU, që në mënyrë të rregullt ballafaqohen me presion më të ulët se niveli minimal i presionit. Nuk përfshihen periudhat e pashmangshme afatshkurtra të presionit të ulët. Është përgjegjësi e ofruesve të shërbimit që të sigurojnë presion adekuat (jo më pak se 1.5 bar dhe jo më shumë se 7 bar), në gypin e lidhjes së konsumatorëve. Sigurimi i presionit mbi vlerën maksimale referente (7 bar), është përgjegjësi e vetë konsumatorëve. Konsumatorët presin nga Ofruesi i tyre i shërbimeve furnizim me një presion të mjaftueshëm dhe me rrjedhje të qëndrueshme (presion adekuatë, për të kryer punët e tyre shtëpiake).




Fig.2. Norma e pronave të raportuara të cilat kanë probleme me presion të ulët.

Si duket në asnjërin nga KRU nuk janë shfaqur probleme të theksuara për sigurimin e presionit në rrjetin shpërndarës. Kompanitë po ashtu kanë pranuar pak ankesa të konsumatorëve sa i përket këtij aspekti. Megjithatë ARRU ka besim të

kufizuar në rezultatet e analizës së saj, rreth numrit të pronave që preken nga presioni i ulët apo i lartë në rubinetat e tyre të furnizimit me ujë. Asnjëra nga KRU nuk ka mundur të sigurojë të dhëna të besueshme për matjet e presioneve, prandaj ne nuk mund të themi me siguri se situata është më e keqe apo më e mirë se sa ajo që tregon fig 2. Kompanitë duhet të sigurojnë informacione të besueshme për presionet në gypat e tyre të shërbimit, dhe për tërë zonën e shërbimit duke vendosur zonat e menaxhimit të presioneve me numër të mjaftueshëm të pikave matëse (manometrave), si dhe vendosjen e një sistemi On-line të monitorimit dhe testimit.

Vazhdimësia e furnizimit me ujësjellës

Tregon normën e pronave (konsumatorëve) të shërbyera në periudhën raportuese që kanë furnizim të vazhdueshëm me ujë të ndarë në tri kategori: prona që kanë furnizim 24 orë, 18-23 orë furnizim dhe prona që kanë më pak se 18 orë furnizim, duke përjashtuar rastet e veçanta që mund të ndodhin siç janë: ndërprerjet nga ndonjë problem teknik apo ndërprerje për punë të planifikuara të Kompanisë.




Fig.3. Norma(%) e konsumatorëve me furnizim të rregullt me ujë të pijshëm

Vazhdimësia e furnizimit me ujë në vitin 2017 është përmirësuar dukshëm. Përmirësimi është evident në KRU 'Prishtina' dhe 'Mitrovica'. Këto dy kompani tani më kanë kapacitete të mjaftueshme për të furnizuar pa ndërprerje konsumatorët e tyre në kuadër të zonave të tyre të shërbimit.

Probleme të vogla kryesisht të natyrës teknike mbeten ende në KRU 'Bifurkacioni', 'Hidroregjioni Jugor' dhe 'Hidromorava'.

Orët mesatare të furnizimit me shërbime të ujësjellësit në ditë nga KRU në nivel sektori, kanë shënuar një rritje nga 22.96 për 2016 në 23.7 në 2017. Vetëm kompania Prishtina dhe Bifurkacioni kanë regjistruar reduktime në orët e furnizimit me ujë.

Edhe në këtë tregues, ARRU ka një dozë rezerve në besueshmerinë e saj, për faktin se të dhënat për pronat e prekura si dhe kozgjatjen e reduktimeve, janë të vlersuara. Asnjë nga kompanitë nuk ka të vendosur një sistem të verifikueshëm. Mungon sistemi SCADA në rrjetin shpërndarës, si dhe zonat e reduktimeve, nuk janë të definuara në ndonjë aplikacion të qëndrueshëm, siç është SIG.

Të gjitha kompanitë, përjashtuar KRU 'Bifurkacioni', tani e tutje duhet të kufizohen në rritjen e kapaciteteve prodhuese. Fokusin duhet orientuar në menaxhimin e prodhimit të ujit dhe faturimit, si dhe eliminimin e problemeve operative-teknike aktuale. Çdo investim në rritjen e kapaciteteve prodhuese do të ndikojë në ngritjen e panevojshme të kostove operative dhe atyre kapitale.

Plasritjet e Gypave

Ky tregues është i lidhur me numrin total të plasritjeve të gypave gjatë vitit për km të gypit (duke përjashtuar gypat e shërbimit të kycjes).




Fig.4. Plasjet e gypave të furnizimit me ujësjellës

Kjo figurë tregon vlerat e plasjeve të gypave për 100 km gyp të rrjetit kryesor të ujësjellësit për çdo KRU. Plasjet /defektet e rrjetit të ujit të raportuara në vitin 2017 për 100 km shkojnë nga 605 plasje/defekte në KRU 'Hidroregjionin Jugor', në 72 plasje në 100 km rrjetë në KRU 'Prishtina'. Mesatarja e plasjeve/defekteve të ujit në mbarë vendin gjatë 2017 është 233/100 km. Performancën me të dobët e ka shënuar KRU 'Hidroregjion Jugor' me 605 plasje /100km të rrjetit shpërndarës të ujit.

Si duket vjetërsia e gypave të rrjetit e sidomos mungesa e mirëmbajtjes adekuate janë faktorët kryesor për këtë performancë të dobët.

Kjo gjendje e numrit të plasjeve /defekteve të rrjetit për 100km, na tregojnë për performancën e dobët të rrjetit të ujësjellësit dhe se sa rrjeti është poroz. Sa më e lartë të jetë kjo normë aq më shumë ndikon në humbjen e ujit dhe në kualitetin e tij.

Uji i pa-faturuar

Uji i Pa-faturuar (UPF), është ndryshimi në mes të sasisë së ujit të trajtuar dhe të shpërndarë në rrjet, në raport me sasinë e ujit të faturuar. Përndryshe është një sasi e ujit e cila nuk sjell të ardhura për KRU.

KRU janë të sfiduara nga një nivel i lartë i UPF. Një normë referimi e pranueshme ndërkombëtarisht të cilin edhe ne e kemi pranuar si objektiv të arsyeshëm, sygjeron që UPF të jetë me e vogël se 25% nga totali i ujit të prodhuar dhe të shpërndarë tek konsumatorët.




Fig. 5. Norma e UPF (%)

Në nivel mesatar të sektorit UPF për vitin 2017 është 58% dhe është për 1% më i lartë se sa ishte në vitin 2016.

Përmirësim i vogël prej 1% është shënuar në KRU "Hidrodrini", përderisa tek KRU e tjera situata me UPF ka mbetur e njëjtë apo edhe duke u përkeqësuar me tej siç është rasti tek KRU 'Prishtina' për 4% dhe KRU 'Bifurkacioni' për 3%, dhe kjo për arsye të rritjes së prodhimit të ujit. Ko është evidente sidomos tek KRU 'Prishtina', ku rritja e prodhimit të ujit nuk ka mundur të përcillet me rritjen e sasisë së ujit të faturuar. Objektivat e vendosura nga kompania në BPRR për vitin 2017, dhe të aprovuara nga ARRUE dhe pse jo sfiduese, nuk kanë arritur të përmbushen në asnjërën prej kompanive.

Tab.2. Vlera e UPF në disa prej treguesve

KRU	UPF(%) -realizuara	UPF(%) - planifikuar	UPF (l/kons./ditë) ²	UPF mil.m ³
Prishtina	57%	47%	679	29.7 mil.m ³
Hidroregjioni Jugor	58%	55%	612	10.1 mil.m ³
Hidrodrini	64%	59%	990	16.4 mil.m ³
Gjakova	47%	46%	547	7.0 mil.m ³
Mitrovica	62%	70%	1,651	17.1 mil.m ³
Bifurkacioni	55%	46%	447	4.1 mil.m ³
Hidromorava	56%	47%	487	4.9 mil.m ³

Uji i pa faturuar nga KRU është i diktuar edhe nga: (i) pasaktësia e matjes së ujit të prodhuar dhe atij të dorëzuar konsumatorëve, (ii) uji i pa-matur kryesisht i shfrytëzuar nga: zjarrfikësit, krojet publike, objektet fetare, një sasi e ujit e përdorur nga vete kompanitë për nevoja të ndryshme të sistemit, uji i shfrytëzuar përmes kycjeve ilegale, si dhe (iii) uji i humbur nga rrjedhjet. Për fat të keq asnjë nga kompanitë nuk ka arritur të kenë një pasqyrë të qartë të gjithë këtyre faktorëve. Ato nuk janë duke zbatuar Bilancin e Ujit, i cili është një parakusht për identifikimin dhe me pastaj menaxhimin-reduktimin efektiv të UPF. Bazuar në rezultatet e besueshmërisë së ulët të të dhënave të verifikuara nga procesi i auditimit, përpjekjet e kompanive për reduktimin e humbjeve të ujit duhet të fokusohen edhe në përmirësimin e saktësisë së ujëmatësve. Në veçanti, ujëmatësit e prodhimit të ujit dhe ujëmatësit e konsumatorëve, ato duhet të testohen sa i perket matjes volumetrike në baza të rregullta.

² UPF l/kons.ditë i rregulluar për orët e furnizimit

Sfida e zvogëlimit të UPF është adresuar edhe nga Institucionet përgjegjëse (Qeveria e Kosovës dhe ARRU). KRU kanë hartuar strategjitë individuale për reduktimin e humbjeve të ujit. Një grup ndërinstitucional (KNMU, NJPM-NP, ARRU dhe SHUKOS) është duke monitoruar në baza periodike zbatimin e planeve të veprimt dhe vlerësimin e progresit në reduktimin e UPF. Reduktimi i humbjeve të ujit për kompanitë pritet të sjellë përfitime në disa fusha kyçe si në: menaxhimin e mirë të resurseve ujore, përmirësimin e performancës, financiare-operacionale, ruajtjen e integritetit të sistemit duke zvogëluar ndërprerjet e furnizimit, si dhe reduktimin e potencialit të kontaminimit brenda sistemit të shpërndarjes së ujit.

3.1.2 Jo-financiare (komerciale)

Përformanca jo financiare (komerciale) fokusohet mbi aspektet komerciale të furnizimit me ujë të tilla si mbuleshmëria me shërbime, matja e ujit dhe ankesat me fokusim në ato aspekte që kanë ndikim në konsumatorë.

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit

Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujësjellës është e definuar si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit që kanë shërbim të furnizimit me ujësjellës nga KRU, përmes rrjetit publik të furnizimit.




Fig.6. Norma (%) e mbulueshmëris së popullatës me shërbime të ujësjellësit nga KRU

Mbulueshmëria me shërbimin e furnizimit me ujësjellës gjatë vitit 2017 në nivel sektori arrin shkallën prej 94%, e që është për 3% më e lartë se sa në vitin paraprak 2016.

KRU 'Prishtina', 'Gjakova' dhe 'Hidrodrini', kanë arritur mbulueshmëri të lartë të popullatës me shërbime në kuadër të zonave të tyre respektive të shërbimeve.

Mbulueshmëria e ultë me shërbimet e ujësjellësit gjatë vitit 2017 vazhdon të jetë në KRU 'Hidroregjioni Jugor' me 70%, 'Hidromorava' me 75%, si dhe 'Mitrovica' me 76%.

Fluksi i madh i lëvizjes së banorëve nga zonat rurale në qytete, lëvizja po ashtu e popullatës në drejtim të kryeqytetit (Prishtinës) ka bërë që KRU 'Prishtina' të ofrojë shërbime edhe për një numër më tepër të popullatës që aktualisht janë banor rezident në pjesë të tjera të Kosovës, por që aktualisht punojnë dhe jetojnë në zonën e kësaj kompanie. Po ashtu disa nga KRU shërbimet e tyre i ofrojnë edhe përtej zonës së tyre të shërbimit siç është rasti edhe me KRU 'Gjakova', e cila ofron shërbime edhe për një numër fshatrash në komunën e Prizrenit.

Ky tregues është analizuar duke marrë për bazë të dhënat e dala nga regjistrimi i fundit i vitit 2011 për ekonominë familjare nga ASK i korrigjuar nga ne, në bazë të koficienti të rritjes së ekonomive familjare vit pas viti, në raport me numrin e

faturave aktuale të raportuara nga KRU. Ne kemi kërkuar nga KRU të sigurojnë të dhëna më të fundit të ekonomive familjare nga komunat ku ato i ofrojnë e shërbimet e tyre, me shpresën se ato janë më të përditësuara dhe si të tilla, ato nuk kanë mundur të sigurohen, prandaj edhe në këtë tregues kemi një dozë rezerve në objektivitetin e analizës.

Matja e ujit

Matja e ujit të konsumuar është një parakusht për të ngarkuar konsumatorët në bazë të konsumit të tyre real, si dhe mund të ndihmojë në nxitjen e përdorimit të kujdesshëm të ujit. Pra, është një mjet i rëndësishëm për kontrollin e konsumit dhe humbjeve të ujit.




Fig.7. Proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës

Figura 7, tregon raportin e mbulimit me ujëmatës të konsumatorëve shtëpiak në çdo KRU, si dhe në mesatare të sektorit. Në përgjithësi, raporti mesatar i mbulimit me ujëmatës për kategorinë e konsumatorëve shtëpiak është rritur për 1%, në vitin 2017, ka arritur në nivelin 93%.

Përmirësime në normën e pajisjes së konsumatorëve me ujëmatës gjatë vitit 2017 janë shënuar në disa prej kompanive përfshirë: KRU 'Mitrovica', 'Hidromorava', 'Bifurkacioni' dhe 'Hidroregjioni Jugor'.

Asnjë nga KRU nuk kanë arritur normën prej 100% matje te konsumatorëve të tyre shtëpiak me ujëmatës. Në rastin më të mirë janë KRU 'Prishtina' dhe 'Gjakova' me 98%, përderisa KRU "Mitrovica" dhe 'Hidromorava", ende ngelin nën nivel mesatar të sektorit me vetëm 68%, respektivisht 87%, ndonëse në vitin 2017/2016 edhe në këto dy kompani është shënuar rritje graduale.

Është detyrim ligjor (ligji nr. 05/L -042, për shërbimet e ujit), që kompanitë të faturojnë konsumatorët e tyre sipas leximit të ujëmatësve. ARRU vazhdimisht ka kërkuar nga KRU që të kenë përmirësim më dinamik në këtë tregues, veçanërisht në KRU 'Mitrovica' dhe 'Hidromorava'.

Kompanitë duhet të njohin rëndësinë e matjes së saktë, si nga pikëpamja e rikuperimit të të ardhurave nga faturimi dhe ndoshta edhe më e rëndësishmja, identifikimi se ku ndodhin humbjet e ujit. Është realitet për momentin se shumica dërrmuese e ujëmatësve në vend janë në shërbim për rreth 10-15 vjet apo me shumë. Ujëmatësit duhet të mirëmbahen dhe zëvendësohen sipas një programi zbatues nga KRU, për shkak të konsumit të rregullt dhe vjetërsisë, pasi ujëmatësat ngadalësohen apo shpejtohen dhe bëhen më pak të saktë me kalimin e kohës.

Ankesat

Numri i ankesave është një tregues i rëndësishëm për vlerësimin se sa janë të kënaqur konsumatorët në lidhje me shërbimin e marrë nga ofruesi i tyre i shërbimeve. Ndërgjegjësimi i konsumatorit luan një rol kritik në sigurimin që ankesat të raportohen dhe zgjidhen brenda një afati kohor të përcaktuar ligjor nga ofruesi i tyre përkatës i shërbimit.




Fig. 8. Numri i ankesave për shërbimet e ujësjellësit

Nga fig. 8, mund të shohim një pasqyrë të numrit të ankesave të regjistruara nga secila prej KRU. Në total kanë qenë 19,759 të adresuara tek të gjitha KRU, numri i tyre është rritur për rreth 5000 sish, apo 37% në raport me vitin 2016. Kjo rritje kryesisht është ndikuar nga numri i ankesave të adresuara në KRU 'Mitrovica'. Mesatarja e përgjithshme e ankesave për 1000/konsumatorë në vitin 2017 është 59/1000 konsumatorë. Më pak ankesa nga kompanitë e tjera janë deponuar në KRU 'Gjakova'(14), 'Bifurkacion'(10) dhe 'Hidromorava' (10) për 1000/konsumatorë.

Shumica e ankesave të natyrës komerciale kanë qenë të lidhura me kontestim borxhi, zbritje-shlyerje e borxhit, si dhe faturim paushall, përderisa në aspektin teknik me tepër janë ankuar konsumatorët për: ndërprerjet e furnizimit me ujë, rrjedhje e ujit, defektet në ujëmatës apo edhe çështjet e lidhura me presionin e ujit, zakonisht kur presioni është shumë i ulët, por herë pas here edhe për presion të lartë.

Kjo rritje e numrit të ankesave, jo domosdoshmërisht tregon përkeqësim të nivelit të shërbimit. Kjo mund të lidhet më shumë me atë se kompanitë (KRU 'Mitrovica') janë duke u marrë dhe menaxhuar më mirë me ankesat e konsumatorëve, si dhe kthimi i besimit të tyre tek ofruesit e shërbimeve, meqenëse ankesat e tyre janë duke u trajtuar.

Autoriteti ka ndarë një notë të ultë të besueshmërisë për të dhënat e ankesave të konsumatorëve. Gjatë procesit të auditimit, ne kemi vërtetuar se në lidhje me regjistrimin e ankesave të konsumatorëve shumica e kompanive kanë aplikacione softuerike- module përkatëse (CRM), por ato nuk janë të përditësuara. Ankesat ende mbahen në ditar-formate të Excelit dhe të shpërndara tek disa KRU, në departamente të ndryshme të kompanisë.

KRU-të duhet të mbajnë një regjistër të përditësuar dhe unik të ankesave të konsumatorëve dhe ato ti zgjidhin brenda një afati kohor të përcaktuar me ligj, sipas Rregullores për standardet minimale të shërbimeve.

3.1.3 Financiare

Performanca financiare fokusohet në aspektet financiare të furnizimit me ujë të tilla si: shitjet, kostot për njësi dhe shpenzimet kapitale për ujësjellës. Të gjitha vlerat financiare të shprehura në euro janë rregulluar/përshtatur në bazë të çmimeve të mesit të vitit 2014, për të siguruar krahasime të duhura nga viti në vit.

Volumi i ujit të shitur

Ky treguesi pasqyron sasin e ujit që realisht është shitur, në raport me shitjet e planifikuara me aplikacionet tarifore të KRU në procesin e rishikimit tarifar për vitin 2017.




Fig.9. Normat sasiore për ujin e shitur nga KRU në raport me vlerësimet sipas planit të biznesit

KRU kishin planifikuar në vitin 2017 të shesin në total 68.6 mil.m³ ujë për konsumatorët e tyre, aktualisht shitjet ishin në 59.9 mil m³ për rrethe 8.7mil.m³, apo për 13% më pak se planifikimet e parapara në biznes planet e tyre për të njëjtin vit.

Shitjet totale të ujit në mesatare të sektorit janë rritur nga 57.6 mil.m³ në 2016 në 59.9 mil.m³ në 2017, e cila është e barabartë me një rritje prej rreth 2.3 mil/m³ apo 4%. Përndryshe KRU aktualisht vazhdojnë të faturojnë-shesin vetëm rreth 40% nga totali i ujit të prodhuar dhe distribuuar tek konsumatorët e tyre.

Norma mesatare e shitjeve në raport me shitjet e planifikuara, ka mbetur në nivel të njëjtë me 87% në këto dy vite (2016-2017).

KRU 'Mitrovica' me (7%) raportoi një normë më të lartë të progresit në raport me planifikimet e saj për vitin 2017, që përndryshe është dukshëm nën mesataren e sektorit në arritjen e planifikimeve të shitjeve të ujit.

KRU 'Gjakova' ka raportuar shitjet më të larta të ujit në raport me planifikimet në mesin e KRU-ve tjera, duke arritur shitjet në normën 98% të planifikimit. Shitjet e realizuara nga KRU 'Gjakova' ishin pak më të ulëta se ato në vitin 2016.

KRU 'Prishtina', 'Hidroregjioni Jugor', 'Bifurkacion' dhe 'Mitrovica', kanë dështuar më së shumti në arritjen e objektivave të shitjeve sasiore në 2017.

Arsyeja kryesore për rritjen e planifikimeve të shitjeve të ujit në biznes planet e KRU ishin projeksionet për rritjen e lidhjeve të konsumatorëve dhe rritja e prodhimit në disa kompani, për ti mbuluar vazhdimësinë e furnizimit. Kjo nën performancë e KRU për dështimin e shitjeve të ujit padyshim se do të ndikojë në sigurimin e të ardhurave të mjaftueshme për nevojat financiare të KRU, në veçanti për financimin e investimeve kapitale.

Vlera e shitjeve (EUR)

Vlera totale e shitjeve të ujit është një tregues i rëndësishëm i performancës financiare përmes të cilës mbulohen shpenzimet operative dhe mirëmbajtja kapitale, duke krijuar vetë qëndrueshmërinë financiare.

Figura si më poshtë paraqet performancën e shitjeve të ujit në krahasim me vlerësimet e planifikuara, ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU për procesin e rishikimit tarifar 2015-2017.




Fig. 10. Norma e vlerës së shitjeve të furnizimit me ujë (EUR) në raport me shitjet e planifikuara

Gjatë vitit 2017 vlerat e shitjeve për çdo KRU ishin më të ulëta se sa vlera e planifikuar, kryesisht për shkak të parashikimeve të dobëta të volumeve të shitjeve siç është përshkruar më sipër në treguesin paraprak (figura 9).

Mos realizimi i volumit të shitjeve ka reflektuar edhe në vlerën e shitjeve dhe si e tillë i ka goditur plotësisht KRU sa i përket burimeve financiare, që do të ishin të nevojshme për të përmbushur planet e tyre të investimeve.

Vlera e shitjeve e realizuar për vitin 2017 në nivel të sektorit për furnizim me ujë ishte 29,4mil.€, ndërsa ajo e planifikuar 33,8 mil.€. Kjo do të thotë se vetëm 87% e shitjeve janë realizuar nga ajo që ishte planifikuar, dhe kjo është me e ulët për 3% krahasuar vitin 2016, kur caku ishte arritur në normën prej 90%.

Sa i përket performancës së shitjeve në nivel të kompanive, këtë vit KRU “Hidromorava” prinë me përqindjen më të lartë të caktut të arritur prej 94% duke e tejkaluar vitin paraprak 2016 për 1%, përderisa KRU “Bifurkacioni” ka arritur vetëm 81% të arrij cakun e synuar, njëherit me një rënie prej 8% nga viti 2016, rezultat i të cilës ka qenë niveli po thuajse i njëjtë i faturimit në euro pa ndonjë ndryshim nga viti i kaluar, përderisa faturimi i planifikuar nga kjo kompani ishte më ambicioz (10% rritje) në vitin 2017 në raport me vitin 2016.




Fig. 11. Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë (%), gjatë 2017 në raport me vitin 2016

Nga figura 11 vërehet se gati tek të gjitha kompanitë shitjet kanë treguar progres gjatë periudhës raportuese 2017 në raport me vitin 2016, në përjashtim të dy kompanive KRU “Bifurkacioni” dhe KRU “Hidroregjioni Jugor”.

Edhe këtë vit sikurse vitin e kaluar KRU “Mitrovica” është kompania e cila prinë me realizimin e shitjeve më të larta dhe atë me një ngritje prej 13.90% në raport me vitin 2016, rezultat i të cilës ka qenë rritja e numrit të konsumatorëve të kyçur në shërbimin e ujësjellësit për 9%, dhe rritja e prodhimit, duke reflektuar pastaj edhe në rritjen e shitjeve volumetrike për 12%.

Shitjet në nivel sektori në 2017 janë më të larta për 3.55% si rezultat i rritjes së shitjeve volumetrike për 4%.

Kostot për njësi e ujit të prodhuar³

Kostoja për njësi e ujit të prodhuar është tregues po ashtu i rëndësishëm financiar në bazë të cilës kuptojmë shpenzimet për një m³ të ujit të prodhuar.




Fig. 12. Kostoja për njësi e ujit të prodhuar EUR/ m³ të ujit të prodhuar gjatë 2017 në raport me vitin 2016

Kostoja mesatare e një njësie uji të prodhuar në 2017 nuk ka pësuar ndryshim krahasuar me vitin 2016. Pra, ka mbetur e njëjtë me 0.045€/m³.

Kemi një ndryshim të gjerë të kostove të prodhimit në KRU. Kjo në masë të madhe është e ndikuar nga lloji i burimit të furnizimit, varësisht prej asaj se burimi a është sipërfaqësor apo nëntokësor, dhe nga faktorët e tjerë siç është mënyra e kaptimit dhe cilësia e ujit të shfrytëzuar. Ky është një rast konkret tek KRU “Hidroregjioni Jugor”, ku kostoja e lartë e ujit të prodhuar është ndikuar nga shpenzimet e larta për trajtimin e ujit, në veçanti nga shpenzimet e larta të energjisë dhe derivateve gjatë funksionimit të pompave.

Përderisa me koston më të ulët tash e sa vite prinë KRU ‘Hidrodriini’ me 0.004 €/m³,

Kostoja totale për njësi për furnizimin me ujësjellës

Kostoja totale për njësi për aktivitetet e furnizimit më ujësjellës paraqet shpenzimet totale për furnizim me ujësjellës (përfshirë shpenzimet operative dhe shpenzimet për mirëmbajtje kapitale, por duke përjashtuar kthimin në kapital dhe borxhet e këqija⁴) në raport me volumin e ujit të shitur për të njëjtën periudhë raportuese.

³ Kostot për njësi për vitin paraprak 2016, janë të rregulluara për normë të inflacionit 1.015.

⁴ Borxhet e këqija sipas Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator, janë të definuara si shuma të të ardhurave të pa-arkëtuara nga viti paraprak.

Kostoja për njësi të furnizimit me ujë (Operative+Mirëmbajtje kapitale)




Fig. 13. Kostoja për njësi e furnizimit me ujësjellës EUR, për m³ të ujit të shitur

Në vitin 2017 në nivel të sektorit, kostoja për njësi e furnizimit me ujësjellës ka qenë 0.38 €/m³, e cila krahasuar me vitin paraprak ka pas një ngritje prej 0.01 €/m³.

Përveç KRU "Mitrovica" dhe KRU "Hidromorava", të cilat në vitin 2017 kanë treguar trende pozitive, në rënie prej 0.01 €/m³ (Mitrovica) respektivisht me 0.02 €/m³ (Hidromorava), të gjitha kompanitë tjera kanë shënuar trende negative në këtë tregues. Rritja e kostove për njësi të ujit të furnizuar në shumicën e kompanive mund ti atribuohet rritjeve të dukshme të shpenzimeve totale operative të shërbimeve të ujit, përkundër rritjeve të shitjeve volumetrike për ujësjellës.

Për dallim nga vitet e kaluara këtë vit KRU "Hidroregjioni Jugor" prinë me koston më të lartë të furnizimit me ujë me 0.44 €/m³, duke shënuar një ngritje po ashtu krahasuar me vitin paraprak prej 0.040 €/m³ si rezultat i mos rritjes së shitjeve volumetrike, përderisa shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale janë rritur në nivelin prej 9%.

Kostoja totale për njësi për furnizimin me ujësjellës e realizuar në raport me atë të planifikuar

Kostoja totale për njësi e furnizimit me ujësjellës është një tregues financiar i cili radhitet në grupin e treguesve kryesor në bazë të të cilëve edhe matet performanca e furnizimit me ujësjellës.

Treguesi i paraqitur grafikisht si më poshtë paraqet raportin (normën) në mes kostos për njësi të furnizimit me ujësjellës të realizuar dhe kostos për njësi të furnizimit me ujësjellës të planifikuar.

Kostoja për njësi e furnizimit me ujë në raport me kostot e planifikuara për njësi




Fig. 14. Kostoja për njësi e furnizimit me ujë në raport me kostot e planifikuara për njësi (%)

Në nivel të sektorit përmbushja e objektivave të kostove për njësi të furnizimit me ujësjellës në 2017, edhe më tej ka devijuar nga objektiva e planifikuar prej 90%, por krahasuar me vitin paraprak ajo është përmirësuar për 12% nga 110% në 98%.

Performancën më të mirë në këtë tregues e ka arritur KRU 'Mitrovica' me realizimin e kostove për njësi në nivel 88%, nivel ky i dëshiruar nga të gjitha kompanitë dhe i cili është arritur fal subvencionit që ka pranuar kjo kompani duke i mbuluar shpenzimet operative të ujit në nivelin prej 38%.

Performanca e dobët është treguar nga KRU 'Bifurkacioni'. Për shkakun e normës së lartë të shpenzimeve operative, mos realizimit të investimeve kapitale, si dhe shitjeve të ujit në vlerat e planifikuara, gjatë procesit tarifarë 2015-2017 respektivisht për vitin 2017).

Shpenzimet kapitale për ujësjellës

Procesi i rishikimit tarifar 2015-2017 kishte përfshirë provizionime për shpenzime kapitale si për mirëmbajtje kapitale poashtu edhe për rritje kapitale. Pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve, sidomos e atyre për mirëmbajtje kapitale, pritej se do të financoheshin nga burimet e veta financiare të KRU dhe për këtë arsye janë përfshirë në tarifa. Ne jemi të zhgënjyer kur shohim se shpenzimet aktuale kapitale të ndërrmarra nga KRU në tri vitet e fundit janë të papërfillshme në krahasim me ato që ishin planifikuar. Një gjë tjetër brengosëse është se kompanitë gati të gjitha shpenzimet kapitale ose më mirë të themi në nivelin prej 95% të tyre i kanë dedikuar në zgjerim të shpenzimeve kapitale dhe pjesën tjetër prej 5% në mirëmbajtje kapitale, fakt ky i cili rezulton me përqendrimin e bazës së aseteve dhe rënie të niveleve të shërbimit. Rritja e UPF në nivel sektori është dëshmi për këtë dështim në ndërmarrjen e aktiviteteve efektive të mirëmbajtjes kapitale brenda rrjetit.

Shpenzimet kapitale për furnizim me ujë në raport me ato të planifikuara për vitin 2017




Fig.15. Shpenzimet kapitale për furnizim me ujësjellës në raport me ato të planifikuara(%)

Sic vërehet nga figura shpenzimet aktuale në shumicën e KRU, në përjashtim të KRU "Prishtina" dhe "Mitrovica", ishin më të ulëta se niveli i pritur dhe atë duke filluar prej 3% të KRU "Hidroregjioni Jugor" e deri të 25.5% të KRU "Hidrodrini".

Për dallim nga vitet e kaluara ku shumica e investimeve të realizuara e të deklaruar nga kompanitë kanë qenë kryesisht nga Grantet (donacionet zhvillimore), këtë vit investimet nga të hyrat vetanake kanë pri me 56% nga shuma totale e investimeve.

Vlera e investimeve nga të hyrat vetanake për vitin 2017 ka qenë rreth 30 mil.€, ndërsa pjesa tjetër prej të granteve. Në nivel të sektorit për vitin 2017 kompanitë nga të hyrat vetanake kanë planifikuar të shpenzohen rreth 3 mil.€ euro të cilat

edhe janë mbuluar nga tarifat e aprovuara, por shumica e tyre në përjashtim të KRU "Prishtina" nuk kanë arrit as 50% të tyre ti realizojnë.

Tab.3. Vlera e investimeve në shërbimin e ujësjellësit nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2017

Kompania	<i>Inv. në prodhim</i>	<i>Inv. në distribuim</i>	<i>Inv. në aktivitete biznesore</i>	<i>Totali</i>
Prishtina	15,479,874	25,188,156	169,357	40,837,387
Hidroregjioni Jugor	113,420	49,899	55,195	218,514
Hidrodrini	7,620	390,034	98,411	496,065
Mitrovica	10,392,020	1,964,858	17,942	12,374,820
Gjakova	0.00	788,809	429,575	1,218,384
Bifurkacioni	21,382	141,828	42,754	205,964
Hidromorava	19,453	9,663	6,640	35,756
Totali	26,033,769	28,533,247	819,874	55,386,890⁵

Këtë vit KRU 'Prishtina' prinë me realizimin e shpenzimeve kapitale prej 40.1 mil.€, dhe 70% e saj është realizuar nga të hyrat vetanake. Me këto shpenzime është synuar të përmirësohet vazhdimësia e furnizimit më ujësjellës

(kryesisht me ndërtimin e fabrikës së ujit në Shkabaj, projekt ky i planifikuar në vitin 2014, vendosjen e pompave, rezervuarve etj).

KRU 'Mitrovica' nga vlera totale e investimeve prej 12.3 mil. € të pranuar 100% nga grantet, pjesën më të madhe të tyre i ka realizuar në rritje të jo infrastrukturës, në resurse dhe atë kryesisht për ndërtimin e fabrikës së ujit në Shipol, ndërsa pjesën tjetër në rritjen dhe përtëritjen e infrastrukturës në distribuim konkretisht në rehabilitimin dhe ndërtimin e rrjetit të ri të ujësjellësit.

KRU 'Gjakova', 'Hidroregjioni Jugor' dhe 'Hidrodrini' kanë realizuar shpenzime kryesisht në rritje të infrastrukturës dhe jo-infrastrukturës në prodhim dhe distribuim dhe atë në zgjerim të fabrikës së ujit, zgjerim i gypave, përtëritje dhe ndërtim të rrjetit të ujësjellësit, ndërtimin e stacionit të pompave, instalim të ujëmatësive, pajisjet për filtrimin e ujit, hapja e bunarëve, ndërtimin e kaptazhave, etj.

Kompania e cila ka realizuar më së paku investime në shërbimet e ujit ka qenë KRU 'Hidromorava', me 35,756 euro ose 4.6% nga ajo e planifikuar.

⁵ Investime të realizuara përgjatë viteve 2014-2017, por të finalizuar dhe kontabilizuar në vitin 2017 (KRU Prishtina dhe Mitrovica)

3.2. SHËRBIMET E UJËRAVE TË NDOTURA

Kjo nën-pjesë analizon performancën e KRU në lidhje me shërbimet e ujërave të ndotura në vitin 2017 dhe bënë një krahasim të trendëve në raport me vitin paraprak 2016, si dhe një analizë kundrejt caqeve / pritjeve që janë të përfshira në rishikimin tarifar 2017. Sikurse për furnizimin me ujë, ne e kemi ndarë këtë analizë në tri nën pjesë kryesore: jo-financiare (teknike), jo-financiare (komerciale) dhe financiare.

3.2.1. jo-financiare (teknike)

Performanca jo-financiare (teknike) fokusohet në aspektet teknike të shërbimeve për ujëra të ndotura të tilla si: cilësia e ujërave të ndotura dhe nivelet e shërbimit me fokusim në ato aspekte që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në konsumatorët.

Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara

Aktualisht shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura në vend është shumë i ultë, ka vetëm një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura në Skenderaj e menaxhuar nga KRU 'Mitrovica' dhe disa impiante të vogla në nivel fshatrash të menaxhuara nga KRU 'Prishtina', nga të cilat nuk kemi mundur të sigurojmë të dhëna adekuate. Pjesa tjetër e ujërave të ndotura të shkarkuara nga KRU është e logjikshme të supozohet se ato nuk arrijnë t'i përmbushin standardet mjedisore. Ne po shpresojmë që në vitet e ardhshme ky shërbim do të jetë funksional, meqenëse kemi hyre në një fazë të: planifikimeve, investimeve dhe ndërtimeve intensive të impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura. Një impiant i tillë me kapacitet të konsiderueshëm tani më është duke u ndërtuar në regjionin e Prizrenit.

Frekuenca e bllokimit të kanalizimit

Tregon numrin e incidenteve të raportuara të kolapseve-blokimeve të kanalizimeve të raportuara nga KRU (ose të identifikuar nga personeli i KRU) në periudhën raportuese në raport me gjatësinë e rrjetit të kanalizimeve. Ky tregues vlerëson performancën e rrjetit të kanalizimit, gjegjësisht dendësinë e bllokimeve të kanalizimeve për 100 km të rrjetit.

Blokimet e kanalizimit për 100 km gjatësi të rrjetit




Fig.16. Numri i bllokimeve për 100 km

Vetëm KRU 'Hidroregjioni Jugor', 'Prishtina' dhe 'Bifurkacioni', kanë raportuar të dhëna për bllokimet e kanalizimit. Përderisa KRU 'Prishtina' ka raportuar një rënie në numrin e bllokimeve të kanalizimit nga 463 në 304, për 100/km. KRU 'Hidroregjioni Jugor' me 450 dhe 'Bifurkacioni' me 298 bllokime për 100km, kanë raportuar rritje të bllokimeve në vitin 2017/2016.

Dendësia e ulët e bllokimeve në KRU 'Hidrodrini', 'Mitrovica', 'Hidromorava' dhe 'Gjakova', është për shkak se këto nuk kanë raportuar të dhëna.

Ky numër i madh i bllokimeve të raportuara nga disa prej KRU pasqyronë gjendjen e dobët të mirëmbajtjes-pastrimit të rrjetit të kanalizimit dhe gjithashtu tregojnë praktika të këqija të përdorimit (të tilla si hedhja e mbeturinave të ngurta në puseta) dhe gjithashtu mbingarkesa e rrjetit.

Ofruesi i shërbimeve duhet të zhvillojë dhe implementojë një program për të inspektuar dhe pastruar gypat e rrjetit të kanalizimit. I tërë rrjeti i kanalizimit duhet të pastrohet së paku një herë në pesë (5) vjet, përderisa inspektimi i të gjitha pusetave të kanalizimit duhet bërë së paku një herë në dy (2) vjet, si dhe duhet të bëhet riparimi i tyre varësisht prej nevojës.

3.2.2. Jo-financiare (komerciale)

Performanca jo-financiare (komerciale) fokusohet në aspektet komerciale të shërbimeve të ujërave të ndotura, si: mbulueshmëria me shërbime dhe ankesat.

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura (kanalizimi)

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura është e definuar si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit që kanë shërbim të ujërave të ndotura (kanalizim).




Fig.17. Mbulueshmëria e popullsisë me shërbime të ujërave të ndotura (%)

Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura-kanalizim në nivel sektori gjatë vitit 2017, arrin në nivelin prej 74%.

Shkallën më të lartë të mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura gjatë vitit 2017 e ka arritur KRU 'Prishtina', sikurse te mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit, vlen të theksohet së ndikim ka pas fluksi i madh i lëvizjes së banorëve nga qytetet tjera dhe regjistrimi i tyre si ekonomi apo konsumatorë të kësaj kompanie.

Nivel të ulët të mbulueshmërisë me shërbimin e ujërave të ndotura vazhdon të jetë në zonën e shërbimit të KRU 'Hidrodrini' me 44%, kjo është për 5% më shumë se në vitin paraprak 2016.

Po ashtu edhe ky tregues ngjashëm si te mbulueshmëria me ujësjellës, është analizuar duke marrë për bazë të dhënat e dala nga regjistrimi i fundit i vitit 2011 për ekonominë familjare nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës i korrigjuar në bazë të koficentit të rritjes së ekonomive familjare vit pas viti, në raport me numrin e faturave aktuale të raportuara nga KRU

Ankesat

Ky tregues paraqet numrin total të ankesave të pranuar nga KRU në lidhje me nivelet e shërbimit (vërshimeve të kanalizimeve etj.), si dhe aspektet financiare-komerciale në lidhje me shërbimin e ujërave të ndotura gjatë periudhës raportuese (tarifat,etj).




Fig.18. Mbulueshmëria e popullatës me shërbime të ujërave të ndotura

Numri i ankesave të pranuar nga KRU për shërbimet e ujërave të ndotura në vitin 2017 është rritur për rreth 1500 në raport me vitin 2016. Kanë qenë në total 6746 ankesa në shërbimin e ujërave të ndotura në vitin 2017 dhe kjo është ekuivalente me 24 ankesa për 1000/konsumator.

Pjesa më e madhe e ankesave për të gjitha KRU ishin të lidhura me çështjet operative siç është bllokimi i kanalizimeve, përfshirë rastet e përmbytjeve dhe pastrimit të kanalizimeve, si dhe për erën nga punët e trajtimit të ujërave të ndotura. Konsumatorët më pak janë ankuar për çështjet komerciale në shërbimin e ujërave të ndotura.

Konsumatorët të cilët marrin shërbim të dobët ose janë të pakënaqur me ndonjë aspekt të shërbimit të ujërave të ndotura (kanalizimit), kanë të drejtë të ankohen. Numri i ankesave mund të merret si pasqyrim i pakënaqësisë së konsumatorit dhe vetëdijes më të madhe të konsumatorëve për të drejtën me shërbime të dinjitetshme dhe trajtim të mirëfillt të ankesave të tyre.

2.2.3. Financiare

Performanca financiare fokusohet në aspektet financiare të shërbimeve të ujërave të ndotura-kanalizimit të tilla si: shitjet, kostot për njësi dhe shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura.

Vlera e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura (EUR)

Figura si më poshtë paraqet performancën e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura në krahasim me vlerësimet e planifikuara ashtu siç ishin të përcaktuara në aplikacionet tarifore të KRU për procesin e rishikimit tarifar 2015-2017, për vitin 2017.

Shitjet e shërbimeve të ujërave të ndotura në raport me shitjet e planifikuara




Fig.19. Vlera (EUR) e shitjeve të shërbimeve të ujërave të ndotura në raport me planifikimet

Për dallim nga shitjet e ujit në raport me planin ku performanca e tyre ishte jo e mirë pa përjashtim tek të gjitha kompanitë, tek ujerat e ndotura tri nga shtatë KRU kanë treguar performancë të mirë tek shitjet aktuale në raport me planin, madje duke i tejkaluar ato për 15% (Hidromorava), 13%(Gjakova), dhe 12% (Hidrodrini).

Vlera e shitjeve e realizuar për vitin 2017 në nivel të sektorit për ujëra të ndotura ishte 3,873,041€ ndërsa ajo e planifikuar 4,165,383€ kjo do të thotë se 93% e shitjeve janë realizuar nga ajo që ishte planifikuar, dhe është më e ulët për 3% krahasuar me vitin 2016 kur ajo ishte 90%.

Edhe këtë vit KRU ‘Hidromorava’ ka arritur përqindjen më të lartë në realizimin e shitjeve të planifikuara, krahasuar me kompanitë e tjera dhe atë me 15% njëkohësisht duke mbetur në pozitën e njëjtë me vitin paraprak, ndërsa % me e ulët e realizimit të shitjeve për ujëra të ndotura në raport me planin sikurse të shitjet e furnizimit me ujit mbetet të KRU ‘Bifurkacioni’ me 82% me një rënie krahasuar me vitin paraprak prej 1%.

Vlera relative e shitjeve të shërbimit të ujërave të ndotura

Vlera relative e shitjeve të shërbimeve për ujëra të ndotura gjatë 2017 në raport me 2016




Fig. 20. Vlera e shitjeve të shërbimit me ujëra të ndotura gjatë 2017 në raport me vitin 2016

Figura me lartë tregon trendët e vlerës së shitjeve të realizuara gjatë periudhës raportuese 2017 në raport me vitin 2016. Gjashtë nga shtatë KRU kanë shënuar progres në këtë tregues gjatë vitit 2017 krahasuar me vitin 2016, në përjashtim të KRU “Bifurkacioni”.

KRU “Mitrovica” është kompania që ka realizuar shitjet më të larta në vitin 2017 me 9.91% në raport me vitin 2016, rezultat i të cilës ka qenë ngritja e numrit të konsumatorëve në shërbimin e ujërave të ndotura për 11%, duke ndikuar pastaj edhe në rritjen e shitjeve volumetrike.

Në vlerë absolute shitjet në nivel sektori në 2017 janë për 3.46% më të larta se sa në vitin 2016.

Kostoja totale për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura

Kostot për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura janë të definuara si kosto vjetore për konsumatorët shtëpiak të shërbyer⁶.




Fig.21. Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura-EUR për konsumatorët shtëpiak

Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura në nivel të sektorit në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 ka qenë më e lartë për 0.41⁷ €/m³ ose 8%.

Si vërehet edhe nga figura më lart në tri nga shtatë kompanitë për vitin 2017, kemi pas rënies të kostos për njësi për shërbimin e ujërave të ndotura, rezultat i të cilave rënie ka qenë ngritja e numrit të konsumatorëve shtëpiak të shërbyer, përkundër rritjeve të shpenzimeve totale për ujëra të ndotura.

Koston më të ulët në këtë tregues për vitin 2017 e ka KRU ‘Prishtina’ me 1.45 €/kons. me një ngritje prej 0.10 €/kons. krahasuar me vitin paraprak, përderisa kosto më e lartë për vitin 2017 në raport me vitin 2016 mbetet te KRU “Bifurkacioni”, me një rritje prej 1.21 €/m³ ose 11%, rezultat i të cilës kanë qenë shpenzimet e larta operative, përkundër rritjes së numrit të konsumatorëve.

Njëkohësisht nga figura vërejmë se KRU “Hidrodrini” është kompania e cila ka arritur të këtë ndryshimin më të lartë të kostos për njësi të ujërave të ndotura në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 dhe atë prej 3.09 euro ose 68%, ku rezultat i

⁶ Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definoen si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri i konsumatorëve jo shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.

⁷ Kostoja për njësi e vitit 2016 është e rregulluar për normën të inflacionit 1.015.

këtij ndryshimi (ritje e kostos) ka qenë kryesisht rritja e shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në shërbimin e ujërave të ndotura në nivelin 197%.

Kostoja totale për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura e realizuar në raport me atë të planifikuar

Kostoja totale për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura është një tregues po ashtu i rëndësishëm financiar i cili radhitet në grupin e treguesve kryesor në bazë të të cilit matet performanca e ujërave të ndotura. Treguesi i paraqitur grafiksht si më poshtë paraqet raportin në mes kostos për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura të realizuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/me ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak⁸) dhe kostos për njësi të shërbimeve të ujërave të ndotura të planifikuar (shpenzimet operative duke përfshirë mirëmbajtjen kapitale/ ekuivalentet e konsumatorëve shtëpiak).




Fig. 22. Kostoja për njësi e shërbimeve të ujërave të ndotura në raport me kostot e planifikuara për njësi(%)

Kostot për njësi të realizuara në raport me ato të planifikuara që rrjedhin nga rishikimi tarifar 2015-2017 (të rregulluara sipas niveleve të çmimeve në 2014), gati të gjitha KRU ishin më të ulëta, dhe kjo nuk tregon efikasitet më të madhe se sa ishte planifikuar, për arsye se kostot e planifikuara për njësi kanë përfshirë shpenzime të konsiderueshme për përtëritje të infrastrukturës dhe zhvlerësimin sipas kostos aktuale për asetet e reja e që asnjëra nuk kanë arritur ti realizojnë.

Edhe pse KRU "Hidroregjioni Jugor", në krahasim me kompanitë e tjera ka arritur përqindjen më të lartë të realizimit nga caku i planifikuar, prapë kjo nuk tregon performancë të mirë, për arsye se ka tejkaluar shpenzimet operative prej 155% duke mos realizuar as 2% të shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale.

Shpenzimet kapitale për ujëra të ndotura

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të realizuara për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimet e ujërave të ndotura, në raport me shpenzimet kapitale të aprovuara në planin e biznesit për vitin 2017.

⁸ Konsumatorët shtëpiak të shërbyer definohej si numri aktual i konsumatorëve shtëpiak plus numri i konsumatorëve jo shtëpiak të konvertuar në ekuivalent të konsumatorëve shtëpiak bazuar në ndarjen proporcionale të ujit të konsumuar.




Fig. 23. Shpenzimet kapitale për shërbime të ujërave të ndotura në raport me ato të planifikuara(%)

Edhe të shërbimi me ujëra të ndotura njëjtë sikur të shërbimi me ujësjellës, kompanitë për vitin 2017 kanë paraparë provizionime të konsiderueshme rreth 14 mil.€ për rritje kapitale dhe mirëmbajtje kapitale, e të cilat janë parapa të sigurohen si nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet, por në realitet shpenzimet aktuale ishin shumë më të ulëta se sa niveli i pritur, në përjashtim të KRU “Prishtina” e cila ka shumë fishuar investimet në raport me planin.

Edhe këtë vit shumica e investimeve të realizuara për ujëra të ndotura janë nga të hyrat vetanake dhe atë prej 349,705€ apo 95% e shumës totale të investimeve, ndërsa pjesa tjetër janë nga grantet gjithsejtë 19,814 €.

Për vitin 2017 kompanitë nga të hyrat vetanake kanë planifikuar të shpenzohen rreth 500,000 euro të cilat edhe janë mbuluar nga tarifat e aprovuara, dhe kompanitë për vitin 2017 sipas planit i kanë realizuar 82% nga ajo që ishte e planifikuar.

Tab. 4. Vlera e realizuar e investimeve në shërbimin e ujërave të ndotura nga të hyrat vetanake dhe grantet për vitin 2017

KRU	Inv.në grumbullim	Inv.në trajtim	inv.në shkarkim	inv.akt. biznesore	Totali
Prishtina	214,063	0	0	5,286	219,349
Hidroregjioni Jugor	0	0	0	8,102	8,102
Hidrodrini	83,608	0	0	10,080	93,688
Mitrovica	0	0	0	1,994	1,994
Gjakova	10,815	0	0	22,609	33,424
Bifurkacioni	0	0	0	10,688	10,688
Hidromorava	1,774	0	0	500	2,274
Totali	310,260	0	0	59,259	369,519

3.3. PERFORMANCA FINANCIARE E KRU

Arkëtimi i të ardhurave

Efikasiteti i arkëtimit paraqet raportin e mbledhjes së të ardhurave të faturuara gjatë vitit, për furnizimin me ujësjellës dhe shërbime të ujërave të ndotura përjashtuar ngarkesat të tjera, siç janë taksat për kycje dhe të ardhurat tjera që kompanitë mund ti kenë si pjesë e biznesit. Ky është njëri prej treguesve më domethënës menaxhues i cili krahas efikasitetit të faturimit dhe reduktimit të humbjeve të ujit, ka impakte të drejtpërdrejta në qëndrueshmërinë financiare të kompanisë.




Fig. 24. Norma e arkëtimit të të ardhurave/ faturimi (duke përjashtuar të ardhurat tjera operative)

Shkalla e arkëtimit për faturat e shërbimit të ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura si mesatare e sektorit për vitin 2017, ishte 84% dhe është për 2% më e ulët se në vitin 2016.

Siç vërehet edhe nga figura performancën dhe progresin dhe më të mirë në shkallën e arkëtimit e ka arritur KRU "Hidroregjioni Jugor" me 95%, e cila ka ndodh si rezultat i fshirjes së borxheve bazuar ne Ligjin për faljen e borxheve publike, riprogramimin e borxheve me këste, puna e vazhdueshme me përmbaruesit privat etj. Performancë të mirë në këtë tregues ka treguar gjithashtu edhe KRU "Hidrodrini" me një ngritje prej 2% krahasuar me vitin paraprak, përderisa KRU e tjera pa përjashtim kanë treguar trende negative.

Caku i Planifikuar për 2017 në nivel të sektorit ka qenë 82%, përderisa ky cak aktualisht në nivel të sektorit ka arrit të tejkalohet për 2%.

Eficienca e ulët e arkëtimit i preket në përgjithësi mos pagesave të faturave nga konsumatorët e amvisërisë, por edhe nga një pjesë e konsumatorëve komercial dhe atyre institucional nga të cilat kompanitë nuk mund të mbledhin keshin e faturuar.

Tab 5. Shkalla e arkëtimit sipas kategorive të konsumatorëve dhe totali për vitet 2016-2017

Kategoria e konsumatorëve	Prishtina		Hidroregjioni Jugor		Hidrodrini		Mitrovica		Gjakova		Bifurkacioni		Hidromorava	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
Amvisëri	87%	85%	88%	98%	77%	78%	50%	48%	93%	88%	79%	81%	78%	76%
kom.-industrial	103%	90%	64%	69%	82%	88%	117%	69%	92%	83%	92%	95%	89%	93%
Institucione	99%	98%	119%	108%	79%	80%	69%	97%	115%	83%	89%	57%	98%	89%
Totali	92%	88%	87%	95%	78%	80%	59%	56%	95%	87%	82%	81%	82%	79%

Tab.5. jep një pasqyrë të shkallës së arkëtimit për dy vitet 2016 dhe 2017, të ndarë për kategori të konsumatorëve, nga e cila vërehet se përmirësimi i normës së arkëtimit tek tri kategoritë e konsumatorëve në shumicën e kompanive mbetet ende sfidë për tu përmirësuar.

Këtë vit, KRU 'Hidroregjioni Jugor' mban rekordin me 98% të arkëtimit në amvisëri, po ashtu kjo kompani prinë edhe në kategorinë e institucioneve me 108%, përderisa KRU "Bifurkacioni" kryeson me normën më të lartë të arkëtimit në kategorinë e bizneseve me 95%.

Në KRU 'Mitrovica' konsumatorët e amvisërisë siç shihet edhe nga tabela me lartë, mbesin paguesit më të dobët të borxheve. Vetëm 48% të tyre arrijnë ti shlyejnë borxhin për shërbimin e ofruar nga ofruesi i tyre i shërbimeve.

Edhe në vitin 2017 masë kryesore e zbatuar për mbledhjen e borxheve të konsumatorëve ka qenë zbatimi i ligjit për faljen e borxheve publike, i cili ka vazhduar deri në Shtator të vitit 2017. Disa KRU kanë zbatuar po ashtu edhe masa operative (shkyçje) dhe ato ligjore (angazhimi i përmbauesve) drejt përmirësimit të efijencës së arkëtimit.

Përmirësimi i efijencës së arkëtimit kërkon angazhim permanent dhe të vazhdueshëm përmes zhvillimit të planeve të qëndrueshme të veprimit, përmirësimin e leximit të rregullt të ujëmatësve, faturim të rregullt, si dhe ndërmarrjen e masave operative dhe ligjore me kohë për konsumatorët e pandërgjegjshëm.

Kthimi në kapital

Tanimë e dimë që nga procesi tarifar 2009-2011 u fut në përdorim koncepti që KRU të sigurojnë një kthimin në kapital si kusht i domosdoshëm për të arritur një nivel huamarrës të mjaftueshëm, për të tërhequr investimet shumë të nevojshme në sektor.

Për procesin tarifar 2015-2017 duke u bazuar në praktikën e mira të vendeve të Evropës Perëndimore, kemi aprovuar një vlerë të vërtetë të kthimit (pas inflacioni) prej 4% në Bazën rregullatore të aseteve (BRRA)⁹.

⁹ Për detaje të mëtejshme mbi Bazën Rregullatore të Aseteve (se si është e definuar dhe e përcaktuar, etj.) referojuni Udhëzimeve të Kontabilitetit Rregullator të ARRU.




Fig.25. Kthimi në bazën rregullatore të aseteve –BRRA (%)

Kthimi në kapital në nivel të sektori ka pasur përmirësim dukshëm më të lartë për vitin 2017 krahasuar me vitin 2016 dhe atë për 2.67%.

Siç vërehet edhe nga figura më lartë, të gjitha kompanitë kanë pasur kthime pozitive dhe atë nga 1.2% të KRU “Bifurkacioni” e deri të 6.5% të KRU “Hidroregjioni Jugor”, nga të cilat vlera kuptojmë se kompanitë kanë arritur me të hyrat e tyre ti mbulojnë shpenzimet e larta operative përfshirë provizionimin e borxheve të këqija dhe mirëmbajtjen kapitale.

Performancën dhe përmirësimin më të lartë në vitin 2017 tek norma e kthimit e ka arrit KRU “Hidroregjioni Jugor” me 8.31% nga -1.8% sa ishte në vitin 2016, në 6.5% në vitin 2017. Ky ndryshim kaq i lartë, përkundër zvogëlimit të shpenzimeve që ka realizuar kjo kompani në krahasim me vitin paraprak, mund ti dedikohet kryesisht ngritjes së të hyrave nga faturimi i rregullt, duke përfshirë edhe subvencionin¹⁰ të cilin e ka pranuar nga komuna.

¹⁰ Subvencioni është pranuar nga komuna për mbulim të shpenzimeve operative për ujëra të ndotura.

3.4. PERFORMANCA E PËRGJITHSHME E KRU

Ky kapitull pasqyron performancën e përgjithshme të sektorit dhe KRU, sipas metodologjisë së zhvilluar nga Autoritetet Rregullator i Shërbimeve të Ujit¹¹. Rangimi i përgjithshëm i një KRU përcaktohet në bazë të rezultateve totale në arritjen e Treguesve Kryesorë të Performancës (TKP), në raport me objektivat afatgjate. Vlersimi dhe rangimi i KRU për vitin 2017 u bë në përputhje me Udhëzimet e Planit të Monitorimit Vjetor (PMV), si dhe ndryshimeve të fundit të bëra në metodologjinë e vlersimit të performancës¹². Ne e kemi vlerësuar performancën e përgjithshme për çdo sektor (furnizimi me ujë dhe ujërat të ndotura) mbi bazën e cilësisë, niveleve të shërbimit, mbulueshmërisë dhe efijencës së kostos. Këto pastaj i kombinoam dhe ju shtuam efijencë komerciale dhe financiare (arkëtimi i të ardhurave dhe kthimi në BRA) për të arritur në një matje të përgjithshme të performancës së KRU. Të gjitha matjet e performancës janë të shprehura si përqindje ku idealja është 100%. Pra, vlerësimi i performancës së përgjithshme bazohet në performancën absolute në lidhje me nivelin 'ideal' të performancës së pritshme të kompanisë që funksionon mirë dhe ofron furnizim efijentë me ujë dhe shërbime të grumbullimit të ujërave të ndotura.

Duke marrë parasysh se sfida e zvogëlimit të ujit të pa faturuar është duke u adresuar gjithnjë e më tepër nga Qeveria e Kosovës si aksionare e KRU, donatorët aktiv në këtë sektorë, kërkesa e vetë KRU, si dhe domosdoshmëria për përmirësimin e vazhdueshëm të kualitetit të të dhënave të raportuara nga KRU, ARRU në vitin 2017 bëri disa ndryshime, dhe skemës aktuale prej 11 (njëmbëdhjetë) TKP i shtoi edhe dy TKP (Uji i pa faturuar(%) dhe Raportimi rregullator). Konformë këtyre ndryshimeve është rishikuar pesha e treguesve në tërësi, si dhe janë vendosur kriteret e vlersimit për këta dy tregues.

Tani janë 13 (trembëdhjetë) tregues kryesorë të performancës së bashku me peshat e tyre të lidhura me: Standardet e shërbimit, performancën financiare dhe operative dhe kualitetin e të dhënave (besueshmëri), siç tregohet në skemën e TKP.

Tab.6. Treguesit kyç të performancës dhe vlerat e benchmarkingut

Grupi	Treguesitk kyç të performancës	Bechmarkingu
Ujë	Cilësia e ujit të pijëshëm	100%
	Presioni	≥1.5-7.0 bar
	Disponueshmëria	24h
	Mbulueshmëria me shërbime	100%
	Efijenca e kostos	BPRR
	Uji i Pa Faturuar	≥25%
Ujëra të ndotura	Cilësia e shkarkimeve	100%
	Besueshmëria	0
	Mbulueshmëria me shërbime të kanalizimit	95%
	Efijenca e kostos	BPRR
Raportim rregullator	Piket (besueshmëria) e përcaktuar prej Auditimit	100%
Financiar / komercial	Profitabiliteti	4%
	Efijenca komerciale	100%

Në bazë të

¹¹ Plani i Monitorimit Vjetor-2011

¹² Vendimi për ndryshimin e vlersimit të përgjithshëm të performancës së KRU-2017

analizave tona, ndryshimet e bëra në skemën e TKP, kanë pas impakt të konsiderueshëm në rezultatin e përgjithshëm dhe rangimin përfundimtar të KRU në vitin 2017, sepse është ulur pesha e tre treguesve (cilësisë së ujit, disponueshmërisë dhe profitabilitetit), të cilët aktualisht kanë një nivel të lartë të përmbushjes së objektivave dhe janë vendosur dy tregues: humbjet e ujit dhe besueshmëria e të dhënave, të cilët lënë shumë vend për tu dëshiruar, sidomos treguesi i UPF është në nivel shumë të ulët dhe larg objektivës së pranueshme. Duke marrë në konsideratë këto fakte ne, gjatë vlerësimit të performancës së përgjithshme në këtë raport do të kufizohemi vetëm në vlerësimin e performancës së përgjithshme për vitin 2017, pa bërë krahasime për progresin nga viti 2016.

3.4.1. PERFORMANCA E FURNIZIMIT ME UJËSJELLËS

Kjo pjesë e raportit paraqet vlerësimin e performancës së përgjithshme të shtatë KRU në shërbimin e furnizimit me ujësjellës. Bazohet në vlerësimin krahasues në lidhje me nivelin 'ideal' të performancës së pritshme të kompanisë që funksionon mirë dhe ofron furnizim eficient me ujë. Vlerësimi vjetor i performancës në shërbimet e furnizimit me ujësjellës është bërë përmes treguesve në vijim:

- (i) Mbulueshmëria me shërbim të ujësjellësit në zonën e shërbimit,
- (ii) Cilësia e ujit të furnizuar,
- (iii) Presioni i ujit,
- (iv) Disponueshmëria,
- (v) Efienca e kostos,
- (vi) Uji i Pa Faturuar

Performanca e përgjithshme e furnizimit me ujësjellës




Fig. 26. Paraqet rezultatet në vlerësimin e performancës së furnizimit me ujësjellës si dhe rangimin e KRU(2017)

Performanca e përgjithshme e shërbimit të furnizimit me ujësjellës në mesatare në vitin 2017, në raport me nivelin e përgjithshme ideal të synuar prej 45%, ka arritur nivelin 34.2% .

KRU 'Gjakova' ka treguar performancën më të mirë në furnizim me ujësjellës në 4 prej 6 treguesve kyç në këtë shërbim. Përfundimi tek treguesit: cilësia e ujit, presioni, vazhueshmëria e furnizimit dhe mbulueshmëria me shërbime është e plotë tek kjo kompani, përderisa UPF dhe Efiçenca e kostove janë dy nga treguesit të cilëve duhet përkushtuar vëmendje e menaxhmentit të kësaj kompanie, për të fituar përmirësim të mëtejshëm. Aktualisht performanca e KRU 'Gjakova' është në nivelin 38.1% nga caku i mundshëm prej 45%.

Në KRU Hidroregjioni Jugor' është treguar performancë më e dobët nga të gjitha KRU. Janë tre tregues (mbulueshmëria me shërbime të ujesjellesit, UPF dhe efiçenca e kostove) ku hapsira e përmirësimit është e dukshme.

Tabela 7. Rezultatet për performancën e përgjithshme të furnizimit me ujësjellës në vitin 2017

KRU	Cilësia e Ujit	Presioni	V. Furnizimit	Mbulueshmëria	UPF	Efic.e kostove	Totali për KRU
Ideal	25.0%	5.0%	20.0%	20.0%	20.0%	10.0%	45%
GJA	25.0%	5.0%	20.0%	20.0%	8.3%	6.7%	38.2%
PE	25.0%	5.0%	20.0%	20.0%	0.0%	8.7%	35.4%
PR	24.9%	5.0%	15.5%	20.0%	1.5%	10.0%	34.6%
MIT	25.0%	5.0%	19.3%	15.2%	0.0%	10.0%	33.6%
GJI	24.9%	5.0%	20.0%	15.0%	2.3%	6.2%	33.0%
FE	24.6%	5.0%	18.4%	18.5%	2.7%	2.5%	32.3%
PZ	25.0%	5.0%	19.9%	14.1%	1.2%	6.1%	32.1%
Sektori	24.9%	5.0%	19.2%	17.5%	2.2%	7.2%	34.2%

Treguesit e standardeve të shërbimit kryesisht janë të qëndrueshëm, ndonëse ende ka hapësirë për përmirësime në treguesin e mbulueshmërisë me shërbime dhe vazhdimësinë e furnizimit nga disa prej KRU.

Kualiteti i ujit, është në nivel të kënaqshëm. Shtatë KRU në total kanë arritur të përmirësojnë edhe me tej cilësinë e ujit, vetëm 0.1%, është devijim nga objektivi.

Presioni, në rrjetin shpërndarës është përmbushur në tërësi. Asnjë nga KRU nuk kanë raportuar të kenë pasur vështësi në sigurimin e presionit adekuat.

Vazhdimësia e furnizimit, është përmirësuar, investimet e ndodhura në KRU 'Prishtina' dhe 'Mitrovica' në zgjerimin e kapacitetve prodhuese, kanë reflektuar në përmirësimin e këtij treguesi. Ende kërkohet angazhim nga KRU 'Bifurkacioni', 'Prishtina' dhe 'Mitrovica'. Aktualisht niveli i përmbushjes së caktuar është 19.2% nga totali i mundshëm prej 20% për këtë tregues.

Mbulueshmëria me shërbime, në mesatare të sektorit ka shënuar rritje. Ende mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit mbetet e ulët në KRU 'Hidroregjioji Jugor', 'Hidromorava' dhe 'Mitrovica'.

UPF, është një prej treguesve që lenë shumë për të deshiruar. Janë dy KRU ('Mitrovica' dhe 'Hidrodrini'), të cilat nuk kanë mundur të sigurojnë asnjë pikë në këtë tregues. Norma e UPF tek këto dy kompani është mbi 60%. Në pozitën më të mirë nga të gjitha KRU e tjera ndodhet KRU 'Gjakova'(8.0%). Norma mesatare e sektorit në këtë tregues në raport me cahun (20%), është shumë e ulët me vetëm (2.2%).

Efiçenca e kostove, në shërbimin e furnizimit me ujësjellës, në raport me kostot e planifikuara, po ashtu është përmirësuar. Nivel i lartë i efiçencës së kostove ka ndodhur në KRU 'Mitrovica' dhe 'Prishtina', përderisa në KRU 'Bifurkacioni', efiçenca e kostove është shumë e ulët me vetëm 2.5% nga totali prej 10%.

3.4.2. PERFORMANCA E SHËRBIMEVE PËR UJËRA TË NDOTURA

Vlerësimi i performancës së përgjithshme të shtatë KRU në shërbimin me ujëra të ndotura, bazohet po ashtu në vlerësimin krahasues në lidhje me nivelin 'ideal' të performancës së pritshme të kompanisë që funksionon mirë dhe ofron shërbime eficientë të ujërave të ndotura. Vlerësimi vjetor i performancës në shërbimet për ujëra të ndotura, bëhet përmes 4 treguesve vijues:

- (i) Mbulueshmëria me sistemin e kanalizimit për ujëra të ndotura në zonat e shërbimit,
- (ii) Cilësia e ujërave të ndotura të shkarkuara,
- (iii) Besueshmëria e shërbimeve për ujëra të ndotura,
- (iv) Efiçenca e kostos.

Performanca e përgjithshme e shërbimit të ujërave të ndotura në mesatare në vitin 2017, në raport me nivelin e përgjithshëm ideal të synuar prej 35%, ka arritur nivelin 13.8%.




Fig 27. Performanca e përgjithshme e shërbimeve të ujërave të ndotura -2017

Vlerësimi i performancës së përgjithshme për shërbimet e ujërave të ndotura edhe këtë vit është bërë në bazë të vetëm dy treguesve (mbulueshmërisë me shërbime dhe efiçenca e kostove). Dy treguesit e tjerë (cilësia e shkarkimit dhe besueshmëria) e para e ndërlidhur me trajtimin e ujërave të ndotura, nuk është vlerësuar edhe këtë vit, për shkak se aktualisht trajtimi i ujërave të ndotura është i kufizuar, si dhe mungojnë të dhënat mbi cilësinë dhe standardet e ujit. Në mënyrë të ngjashme, pasi që besueshmëria për të gjitha KRU (e matur mbi bazën e vërshimeve / bllokimeve për 100 km gyp në vit) është më e lartë se maksimalja absolute prej 10 nga niveli ideal, dhe të dhënat nga disa KRU të tjera nuk janë raportuar, edhe këtë tregues nuk e kemi vlerësuar.

Në total diagrami i performancës i treguar në fig 27, ilustron nevojën për investime të konsiderueshme në përmirësimin e infrastrukturës së ujërave të ndotura, duke përfshirë: zhvillimin e impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura dhe objekteve përcjellëse.

Tabela 8. Rezultatet për performancën e përgjithshme në shërbimin e ujërave të ndotura në vitin 2017

KRU	Cilësia e shkarkimeve	Besueshmëria	Mbulueshmëria	Efic. e kost	Totali
<i>Ideal</i>	20%	20%	50%	10%	35%
<i>PR</i>	0.0%	0.0%	50.0%	4.2%	19.0%
<i>FE</i>	0.0%	0.0%	40.4%	6.4%	16.4%
<i>GJA</i>	0.0%	0.0%	36.0%	8.7%	15.6%
<i>GJI</i>	0.0%	0.0%	32.6%	5.8%	13.5%
<i>MIT</i>	0.0%	0.0%	29.3%	3.7%	11.5%
<i>PZ</i>	0.0%	0.0%	30.9%	1.9%	11.5%
<i>PE</i>	0.0%	0.0%	21.9%	4.2%	9.1%
Sektori	0.0%	0.0%	34.5%	5.0%	13.8%

Shërbimi i ujërave të ndotura në nivel të përgjithshëm në vitin 2017 ka shënuar përmirësim, ku totali i pikëve është 13,8%, Kjo është për 21.2% më i ulët se sa niveli ideal i synuar në këtë shërbim prej 35%. KRU 'Hidrodrin' dhe 'Mitrovica', 'Hidroregjioni Jugor' dhe 'Hidromorava', kanë nivel dukshëm më pakë të mbulueshmërisë me shërbime të kanalizimi në raport me KRU-të e tjera, dhe janë shumë larg objektivës së synuar në këtë tregues. Kostot për njësi të realizuara në raport me ato të planifikuara për vitin 2017 në të gjitha KRU ishin më të ulëta, dhe kjo tregon efikasitet më të ultë se sa ishte planifikuar.

Eficienta e kostove në shërbimin e ujërave të ndotura gjendet në nivelin e 5%. Performancë më të mirë në këtë tregues ka shënuar KRU 'Gjakova', përderisa një nivel shumë të ultë të efikasitetit të kostove ka treguar KRU 'Hidroregjion Jugor'.

KRU 'Prishtina' ka performancën më të mirë në këtë shërbim në raport me kompanitë e tjera, me tendencë të përmirësimit gradual. Përderisa kompania e cila ka performancën më të dobët vazhdon të jetë KRU 'Hidrodrini'.

3.4.3. PERFORMANCA E PËRGJITHSHME

Përformanca e përgjithshme e KRU bashkon performancën e dy sektorëve të biznesit: furnizimit me ujësjellës dhe ujërave të ndotura e po ashtu edhe të aspekteve më të gjëra komerciale (profitabiliteti dhe arkëtimi i të ardhurave), si dhe raportimit rregullator.

- (i) Performanca e përgjithshme në furnizim me ujë,
- (ii) Performanca e përgjithshme e shërbimit të ujërave të ndotura,
- (iii) Raportim rregullator,
- (iv) Profitabiliteti,
- (v) Efiçenca komerciale.

Performanca e Përgjithshme e KRU




Figura 28. Performanca e përgjithshme e KRU në 2017

Performanca e përgjithshme e KRU 2017, ka arritur në shkallën 62.5%. Nevojitet përmirësim i përgjithshëm edhe për 37.5%, për të arritur maksimalen prej 100%. Shihet qartë, pa asnjë përjashtim, KRU janë duke operuar në nivele shumë më të ulëta se çfarë do të konsiderohej një nivel minimal, p.sh. le të themi, 80% e ideale. Dihet se arsyet kryesore që ndikojnë në performancën e përgjithshme janë: shërbimet e ujërave të ndotura, dhe mungesa e trajtimit, uji i pa faturuar tek shërbimi i furnizimit me ujë, si dhe efienca komerciale (arkëtimi).

Në figurën 28, është pasqyruar rangimi i KRU sipas performancës së tyre për vitin 2017, dhe në raport me kompaninë Ideale.

Bazuar në kriteret e përgjithshme të rangimit, KRU 'Gjakova' dhe KRU 'Prishtina', dolën si kompanitë më të mira në performancën e përgjithshme (në ofrimin e shërbimeve të ujit), pasi shënuan pikë të njëjta. Nga ana tjetër, KRU 'Mitrovica', ishte performuesi më i dobët në performancën e përgjithshme.

Tabela 9. Rezultatet për performancën e përgjithshme të KRU në vitin 2017

KRU	Furnizim me ujësjellës	Ujëra të ndotura	Profitabiliteti	Arkëtimi	Raportimi rregullator	Total i Pikëve
Ideal	45.0%	35.0%	5.0%	10.0%	5.0%	100.0%
GJA	38.2%	15.6%	5.0%	6.8%	4.9%	70%
PR	34.6%	19.0%	5.0%	7.0%	4.8%	70%
PZ	32.1%	11.5%	5.0%	8.7%	4.6%	62%
GJI	33.0%	13.5%	5.0%	4.9%	4.9%	61%
FE	32.3%	16.4%	1.5%	5.2%	4.6%	60%
PE	35.4%	9.1%	4.0%	5.0%	4.3%	58%
MIT	33.6%	11.5%	4.3%	0.0%	4.2%	54%
Total	34.2%	13.8%	4.6%	5.4%	4.6%	62%

- 37.5%

Furnizim me ujë, Performanca e përgjithshme e shërbimit të furnizimit me ujësjellës në mesatare në vitin 2017, në raport me nivelin e përgjithëshëm ideal të synuar prej 45%, ka arritur nivelin 34.2%. Ndonëse trendet pozitiv janë evidente në cilësinë e ujit dhe vazhdimësinë e furnizimit, mungon edhe një normë prej 10.8%, progres për të arritur eficienten e plotë në këtë shërbim. Potencial i madhë për përmirësim ekziston sidomos në tregusin e UPF, por përmirësim i konsiderueshëm, kërkohet edhe tek mbulueshmeria me shërbime të ujësjellësit dhe efienca e kostove.

Shërbimi i ujërave të ndotura, është dukshëm më i ulët se ajo e furnizimit me ujë. Në vitin 2017, është arritur niveli 13.8%, nga maksimalja e mundshme prej 35%, përmirësime ka ndodhur tek Mbulueshmeria me shërbime dhe efienca e kostove, megjithëse trajtimi i ujërave të ndotura ende është i ultë.

Profitabiliteti, paraqet kthimin aktual në bazën rregullatore të aseteve në raport me kthimin në kapital të projektuar. Për procesin tarifor (2015-2017), norma e kthimit në kapital ka qenë 4%. Shkalla e profitabilitetit në mesatare të sektorit për 2017, ishte realizuar në nivelin prej 5.3%, kjo ishte dukshëm më e përmirësuar se një vit më parë (2016). Pa përjashtim të gjitha KRU kanë pasur kthime pozitive. Janë 5 KRU (Prishtina, Gjakova, Bifurkacion, Hidroregjion Jugor, dhe Hidromorava) që kanë arritur performancë maksimale në shkallën e profitabilitetit. Performanca e përgjithëshme në këtë tregues është realizuar në nivelin 4.6%, nga total i mundshëm prej 5%.

Efienca e arkëtimit, aktualisht ndodhet në gjysmën e objektives së synuar me 5.4% pikë të arritur nga maksimalja 10% e ndarë për këtë tregues. Efienca e arkëtimit vit pas viti është duke shënuar përmirësim, në dy vitet e fundit është shënuar një progres më i madh. Të gjitha KRU kanë shënuar përmirësime. KRU 'Hidroregjioni Jugor' me 8.7%, KRU 'Prishtina' me 7%, dhe KRU 'Gjakova' me 6.8%, kanë treguar performancën më të mirë nga të gjitha KRU-të e tjera në këtë tregues në 2017. Normën dukshëm më të dobët në shkallën e arkëtimit ende e ka KRU 'Mitrovica'. Progresi po tregohet të jetë shumë i vështirë, sidomos mbetet sfida përmirësimi i arkëtimit te konsumatorët e amvisërisë dhe të bizneseve.

Raportim rregullator-Kualiteti i të dhënave të raportuara është vlerësuar përmes procesit të auditimit/verifikimit bazuar në atë se sa praktikën e KRU për mbajtjen e të dhënave përputhen me një grup të caktuar të kriterëve të notimit nga 'Udhëzuesi për avancimin e sistemit të monitorimit në ARRU dhe në KRU'. Masatarja e përgjithëshme e këtij treguesi është në nivelin 4.6% nga Toatli prej 5%. Edhe më tej mbesin shqetësimet e ARRU në lidhje me besueshmërinë e disa të dhënave operative (prodhimi i ujit, presioni, reduktimi (prorat me furnizim të kufizuar). Baza e të dhënave financiare dhe shërbimeve ndaj konsumatorëve në përgjithësi mbahen në module softuerike të avancuara dhe këto të dhëna në përgjithësi kanë rezultuar të jenë më të besueshme.

4. PERFORMANCA E SEKTORIT TË SHËRBIMEVE TË UJIT

Zona e shërbimeve të ujit (furnizim me ujësjellës dhe shërbime të ujërave të ndotura) në Kosovë është ndarë në shtatë regjione. ARRU në bazë të përgjegjësisë ligjore ka licencuar shtatë KRU (Kompani Rajonale të Ujësjellësit) për të ofruar këto shërbime në kuadër të zonave të tyre respektive. KRU janë të vetmet kompani publike përgjegjëse për të ofruar shërbime të ujit.

Tek kjo pjesë e raportit është prezantuar performanca e përbashkët e shtatë KRU-ve, përmes disa treguesve të rëndësishëm me fokusim në: prodhim, shitje, mbulueshmëri, qarkullim, investime etj. Treguesit e analizuar janë marrë për një periudhë pesë vjeçare me qëllim që të kemi një pasqyrë sa më të qartë rreth trendëve të zhvillimit të tyre.

4.1. UJI I PRODHUAR, SHITJET DHE UPF

Në figurën e mëposhtme është dhënë trendi i UPF, në nivel sektori në raport me prodhimin dhe shitjet e ujit për periudhën 2013-2017.




Fig.29. Vlerat sasiore të prodhimit, faturimit dhe UPF

Prodhimi total i ujit nga KRU ka shënuar rritje të vazhdueshme nga 134.4 mil. m³ në 2013 në 154.2 mil.m³ në 2017, e cila është e barabartë me 15% apo në vlerë sasiore rreth 20 mil.m³, gjatë periudhës 5 vjeçare (një rënie e prodhimit kishte ndodhur në vitin 2014, atëherë kur ishte një periudhë ekstreme e thatësisë).

Kryesisht rritja e prodhimit të ujit ka ndodhur tek KRU "Prishtina" dhe KRU "Mitrovica" si rezultat i ngritjes së kapaciteteve të reja prodhuese në këto dy kompani e cila ishte parë e domosdoshme për të përmirësuar vazhdimësinë e furnizimit me ujë.

Shitjet vëllimore të ujit, 2017/2013 po ashtu janë rritur për rreth 6.7 mil.m³. Aktualisht vlera sasiore e shitjeve është 64,7mil.m³.

Me rritjen e prodhimit të ujit është rritur edhe vëllimi i ujit të pa faturuar në vitin 2017, kjo vlerë është mjaftë e lartë, rreth 89.4 mil.m³ apo rreth 13 mil.m³ me tepër ujë të pa faturuar, se sa në vitin 2013.

Është evidente që trendi i prodhimit të ujit nuk është përcjellur me një rritje të njëjtë të efikasitetit të faturimit, duke ndikuar që rritja e UPF, si në vlera sasiore ashtu edhe në përqindje të jetë më e lartë në vitin 2017.

4.2. MBULUESHMËRIA ME SHËRBIME

Në zonën e shërbimeve të KRU vlerësohet së jetojnë një popullatë prej 1.7 mili. njerëz, prej të cilëve rreth 1.6 mil. njerëz apo 94%, marrin shërbime të sigurta të ujësjellësit, pjesa tjetër e popullatës vendore llogaritet të jetë në zonat kryesisht rurale të cilat kanë ujësjellës të veçantë apo edhe sisteme individuale, të cilat nuk menaxhohen nga ana e KRU. Me shërbime të ujërave të ndotura janë rreth 1.2 mil. njerëz apo 74% e tyre.

Numri i përgjithshëm i konsumatorëve në vitin 2017 është 338,154 me një rritje prej 10,868 në raport me vitin paraprak. Konsumatorët shtëpiak janë rritur për 10,412 përderisa ata jo shtëpiak (komercial-Industrial dhe institucione), për 456 konsumatorë.




Fig.30. Mbulueshmëria me shërbime

Mbulueshmëria me shërbime ka shënuar përmirësime të vazhdueshme. Në vitin 2017, mesatarja e mbulueshmërisë së popullatës me shërbime të ujësjellësit arriti në nivelin 94%, kjo është më e lartë për 12% në raport me vitin 2013, përderisa mesatarja e mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura është 74%, dhe në këtë periudhë pesë vjeçare është rritur për 14%.

Tab.10. Norma e mbulueshmërisë së popullatës me shërbime për periudhën 2013-2017

Mbulueshmëria me shërbime	Ujësjellës	Ujëra të ndotura (kanalizim)
2013	82%	60%
2014	84%	62%
2015	87%	65%
2016	91%	69%
2017	94%	74%

4.3. TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA, QARKULLIMI DHE PARAJA E GATSHME E ARKËTUAR

Qarkullimi nënkupton të hyrat nga faturimi i rregullt dhe të hyrat tjera operative për shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.

Figura 29, tregon efikasitetin mesatar të qarkullimit dhe inkasimit gjatë 5 viteve, dhe jep një pasqyrë më të qartë të qarkullimit dhe arkëtimit gjatë viteve duke eliminuar shtrembërime që mund të ndodhin gjatë një viti financiar.




Fig. 31. Performanca financiare e sektorit

Efiçenca e Qarkullimit¹³, në vlerë monetare në nivel sektori gjatë vitit 2017 ka shënuar një përmirësim të lehtë, dhe atë për 841 mijë € apo shprehur në përqindje për 3% në raport me vitin 2016. Ky përmirësim i lehtë i atribuohet zgjerimit të bazës së konsumatorëve vit pas viti, e më pas edhe ngritjes së efikasitetit të të ardhurave nga faturimi. Qarkullimi në vitin 2017/2013, në vlerë monetare është përmirësuar për 4.1 mil. €, apo shprehur në përqindje 14%.

Për dallim nga Efiçenca e qarkullimit, Efiçenca e arkëtimit në vitin 2017 në raport me vitin 2013, ka shënuar përmirësim dukshëm me të lartë dhe atë prej 7.1 mil.€, apo shprehur në përqindje për 36%, përderisa krahasuar me vitin paraprak 2016 ka mbetur në nivel të njëjtë.

Shkalla e arkëtimit në raport me faturimin në nivel të sektorit në vitin 2017 ishte 84% apo 2% më e ulët, krahasuar me vitin 2016, përderisa krahasuar me vitin 2013 shkalla e arkëtimit është me e lartë për 13%.

¹³ Qarkullimi ka përfshirë të hyrat nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit dhe kanalizimit, si dhe të hyrat nga aktivitete të tjera operative, Keshi ka përfshirë arkëtimin nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit dhe kanalizimit si dhe të hyrat nga aktivitete të tjera operative.

Tabela 11. Qarkullimi dhe arkëtimi sipas viteve

Vitet	Qarkullimi	Arkëtimi/keshi	Keshi/Qarkullimin
2013	29,715,954.43	21,225,741.79	71%
2014	29,296,792.70	21,890,722.67	75%
2015	32,125,817.68	23,969,835.35	75%
2016	32,980,466.89	28,486,856.51	86%
2017	33,821,692.45	28,393,970.12	84%

Niveli prej 84% i Efijencës së arkëtimit është mesatarisht i kënaqur, meqenëse ende 16% e borxheve nga konsumatorët mbetet pa u inkasuar. Edhe pse kompanitë janë përpjekur që përmes aplikimit të ndërprerjeve të shërbimeve të ujit, fshirjes së borxheve të vjetra dhe adresimit të mbledhjes së tyre përmes përmbauesve privat, dhe riprogramimit të borxheve, prapë nuk kanë arritur nivelin e duhur prej 100%.

4.4. INVESIMET KAPITALE PËR FURNIZIM ME UJËSJELLËS DHE SHËRBIME TË UJËRAVE TË NDOTURA

Ky seksion paraqet analizën e shpenzimeve kapitale të shtatë KRU, reale dhe ato të planifikuara përgjatë procesit tarifar (2012-2014) i cili ka përfunduar, dhe procesit aktual (2015-2017).

Është e qartë se financimi drejt sektorit të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura ka nevojë për mbështetje dhe përpjekje të bashkërenduara nga akterë të ndryshëm. Edhe pse ka pasur fonde të kanalizuar në drejtim të investimeve në këtë sektor, ka ende nevojë të bëhet shumë më tepër, duke pasur parasysh kërkesat e mëdha për investime.

Nga të gjitha KRU pritej që të realizohen investime të konsiderueshme në shërbimin e furnizimit me ujësjellës dhe në shërbimin e ujërave të ndotura. Nga totali i shumës së planifikuar për periudhën trevjeçare tarifore (2015-2017), prej afro 132 milion €, e ndarë afërsisht me 2/3 në furnizim me ujësjellës dhe 1/3 në shërbimin e ujërave të ndotura, nga mjetet vetanake (të KRU), ishte planifikuar të investohen rreth 14 milion € shpenzime kapitale në të dy shërbimet (furnizim me ujësjellës dhe shërbime të ujërave të ndotura)

Tabela.12. Vlera totale e shpenzimeve kapitale për ujësjellë dhe ujëra të ndotura

Kompania	2013	2014	2015	2016	2017
KRU 'Prishtina'	9,027,945	1,592,704	964,011	750,874	40,844,354
KRU 'Hidroregjioni Jugor'	1,552,776	909,195	1,154,620	1,185,597	314,301
KRU 'Hidrodrini'	901,5647	802,008	2,034,939	243,840	516,038
KRU 'Mitrovica'	2,060,993	0.00	0.00	8,377,055	12,374,820
KRU 'Gjakova'	1,348,647	1,166,757	1,310,426	2,140,844	1,243,658
KRU 'Bifurkacioni'	58,461	3,060,203	279,182	156,414	210,232
KRU 'Hidromorava'	32,350	1,971,971	204,840	118,783	253,006
Totali	14,982,737	9,502,839	5,948,018	12,973,406	55,756,409

Vlera e investimeve përgjatë këtyre 5 viteve ka qenë rreth 99 mil. €, mjete të investuara kryesisht nga donatorët, si dhe një pjesë e vogël nga KRU. Në raport me vlerën e planifikuar realizimi i investimeve arrin në nivelin prej 54%.

Nga shume e përgjithshme gjatë këtyre 5 viteve rreth 53.2 mil. €, janë realizuar nga KRU "Prishtina", dhe 22.8mil. € nga KRU 'Mitrovica', përderisa me pak shpenzime kapitale janë realizuar në KRU "Hidromorava"(2.6 milion Euro).

Mungesa e realizimit të investimeve të parapara sipas lartësisë dhe dinamikës së planifikuar në shumicën prej kompanive, qoftë nga mjetet vetanake qoftë me mjetet financiare nga donatorët do të sjellë mungesë në përmirësimet e planifikuara, në veçanti në mos mirëmbajtjen e duhur dhe rritjen e aseteve të cilat janë parakushte për ofrimin e shërbimeve të mira dhe të qëndrueshme.

5. PERFORMANCA E NPH "IBËR-LEPENCË"

ARRU është përgjegjës për rregullimin e pjesës së afarizmit të NPH 'Ibër Lepenci', e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU Mitrovica dhe KRU 'Prishtina' gjegjësisht për Nj.O 'Drenas'.

Në vazhdim po i japim disa të dhëna statistikore dhe disa tregues të performancës për të parë trendet e zhvillimit të performancës në vitin 2017 në raport me vitin 2016.

Tabela 13. Të dhënat statistikore për NPH 'Ibër-Lepenci'

Të dhënat statistikore për 2016 / 2017	2016	2017
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m3)	24,240,235	38,040,970
Faturimi për ujin me shumicë (€)	539,543	1,265,859
Arkëtimi për ujin me shumicë (€)	239,014	762,739
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	665,709	969,911
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	39	51

Sasia e ujit të shitur në vitin 2017 është shtuar për rreth 14.mil m³, uji i shitur për KRU 'Prishtina', si kërkesë për fabrikën e re në Shkabaj.

Megenëse natyra e shërbimeve të ujit me shumicë është më ndryshe nga aktivitetet e furnizimit me ujë të pijshëm, dhe mungesë së Kompanive të tjera me natyrë të njëjtë të furnizimit në vend, mundësia e vlerësimit të performancës është e kufizuar vetëm në disa tregues financiar dhe vetëm për NPH 'Ibër Lepenci'.

Në tabelën 14, është dhënë një pasqyrë e treguesve financiar në bazë të cilëve mund të vlerësohet performanca e NPH 'Ibër Lepenci' gjatë vitit 2017, krahasuar me vitin 2016.

Tabela 14. Treguesit e Performancës së NPH 'Ibër-Lepenci'

Treguesi i performancës	2016	2017
Shkalla e arkëtimit	44%	79%
Norma e punës	0.81	1.00
Norma e mbulimit të punës	0.36	0.79
Kostoja e operimit për njësi (€/m3)	0.03	0.03

Siç po vërehet edhe nga tabela më lartë, gati të gjithë treguesit financiar të kësaj ndërmarrje kanë shënuar progres në vitin 2017 në raport me vitin 2016.

Shkalla e arkëtimit në vitin 2017 është ngritur për 35% krahasuar me vitin 2016, dhe kjo ka ndodh si rezultat i arkëtimit në nivelin prej 80% nga KRU "Mitrovica", dhe nga KRU "Prishtina", të shumës së faturuar.

Rritja e shkallës së arkëtimit ka ndikuar që edhe norma e mbulimit të punës të jetë më e lartë krahasuar me vitin 2016, nga 0.36 në 0.79, megjithatë ky nivel ende mbetet nën nivelin e dëshiruar për ti mbuluar shpenzimet e krijuara gjatë vitit 2017.

Shpenzimet operative për njësi në vitin 2017 kanë mbetur në nivelin e njëjtë me vitin 2016, prej 0.03 Euro/m³.

6. AKTIVITETE E KKK

Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve janë themeluar nga ARRU, me përgjegjësi për të:

- Këshilluar dhe rekomanduar Autoiritetin për çështjet me rëndësi në lidhje me ofrimin e shërbimeve,
- Shqyrtuar dhe zgjidhur ankesat e konsumatorëve të cilat nuk janë trajtuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe për të cilat konsumatori nuk është i kënaqur me përgjigjen e marrë nga ofruesi i tyre i shërbimeve.

Roli i KKK në përgjithësi është të sigurojë që zëri i konsumatorit të dëgjohej tek Rregullatori. Janë pjesë e procesit rregullator dhe janë konsultuar për çështje të ndryshme në interes të konsumatorëve.

Komisionet funksionojnë në shtatë regjione të Kosovës, ku secila komunë brenda rajonit të përcaktuar e ka nga 1 (një) përfaqësues. Anëtarët e këtyre komisioneve janë të zgjedhur sipas propozimeve nga Komunitatet respektive të regjionit në të cilin ofron shërbimet një KRU. Ata veprojnë brenda kompetencave të deleguara nga ARRU dhe marrin mbështetje financiare të kufizuar për të mbuluar aktivitetet e tyre.

KKK në 2017 kanë mbajtur 92 takime, 12 takime më shumë se sa në vitin 2016, në të gjitha regjionet për çdo muaj. Takimet kanë qenë të hapura për publikun ku në shumicën e rasteve kanë marrë pjesë konsumatorët, gjithashtu edhe përfaqësuesit e Kompanive Rajonale të Ujësjellësit.

Në këto takime janë shqyrtuar një numër i konsiderueshëm i ankesave të konsumatorëve dhe çështje të ndryshme nga domeni i interesimit të tyre siç janë: procedurat e KRU lidhur me shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve, leximit të ujëmatësve, tarifave për ujësjellës dhe kanalizim dhe çështje të tjera të cilat janë në interes të tyre.

Tabela 15. Numri i ankesave të parashtruara dhe të zgjidhura

REGJIONI	2016		2017	
	Ankesa të parashtruara	Ankesa të zgjidhura	Ankesa të parashtruar	Ankesa të zgjidhura
KKK -Prishtinë	212	189	167	147
KKK -Mitrovicë	1	1	2	1
KKK- Pejë	0	0	-	0
KKK -Gjakovë	14	12	12	8
KKK- Prizren	6	6	13	11
KKK -Ferizaj	50	39	57	47
KKK -Gjilan	19	13	15	14
Gjithsejtë	302	260	266	228

Kanë qenë në total 266 ankesa të adresuar në 7 (shtatë) KKK. Më së shumti janë ankuar konsumatorët shtëpiak (234), konsumatorë komercial-industrial (27) dhe vetëm në (5) raste janë ankuar institucionet. Janë shqyrtuar të gjitha ankesat e konsumatorëve prej të cilave 228 janë zgjidhur. Shumica e ankesave (240) sish, kanë qenë të natyrës komerciale-financiare (kontestim borxhi, zbritje-shlyerje e borxhit, si dhe faturim paushall).

Sikur edhe në vitin e kaluar 2016, me shumë konsumatorë janë ankuar nga KKK i regjionit të Prishtinës (167) si dhe në regjionin ku shtrin shërbimin KRU Bifurkacioni (47). KKK në regjionin e Pejës vazhdon të mos ketë asnjë ankesë të adresuar nga konsumatorët e KRU 'Hidrodrini'.

7. SFIDAT PËR TË ARDHMEN

• Menaxhimin efektiv i shërbimeve të ujit

Ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave ndotura përballen me shumë sfida që janë thelbësore për një menaxhim efektiv të shërbimeve, që nga aspekti organizativ i punëve dhe stafit, komunikimi ndërmjet menaxhmentit të brendshëm dhe akterëve të jashtëm, përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare dhe operative dhe deri të shërbimi ndaj konsumatorëve. Në vazhdimësi kemi diskutuar për sfidat e ofruesve të shërbimeve edhe në këtë pjesë të këtij raportit do të diskutojmë për sfidën e përgjithshme – **‘Menaxhimi efektiv i shërbimeve të ujit’**, duke u fokusuar në dy aspekte: menaxhimi i aseteve dhe menaxhimi i humbjeve të ujit, të dyja me ndikim të madh në qëndrueshmërinë operative-financiare të kompanive. Aktualisht këto dy çështje janë prioritet dhe si të tilla janë adresuar, si nga ofruesit e shërbimeve ashtu edhe institucionet vendore dhe donatorët.

• Menaxhimi i Aseteve

Menaxhimi i aseteve është ndër përbërësit kryesor biznesor që duhet të jetë bazament/nxitës i të gjitha veprimtarive që ushtrohen nga kompania e ujit. Si i tillë ai nuk është një aktivitet anësor që mund të përfundojë në një afat të caktuar, por është një proces i vazhdueshëm. Infrastruktura e vjetruar dhe jo funksionale, ka nevojë për më shumë vëmendje dhe nevojë për menaxhim të aseteve, përpjekje intensive, riparimi dhe zëvendësimi. Të gjitha sistemet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura janë të përbëra nga asetet, siç janë: gypat, valvulet, rezervuarët, pompat, puset, objektet e trajtimit dhe cilindo, komponent tjetër që bënë pjesë në sistem. Asetet që janë pjesë përbërëse e sistemit të ujësjellësit dhe atij të ujërave të ndotura, humbasin vlerën me kalimin e kohës dhe me përkeqësimin e sistemit. Paralelisht me këtë përkeqësim mund të bëhet më e vështirë për të siguruar/ofruar nivelin e shërbimit të dëshiruar nga konsumatorët e kompanisë. Kostot e operimit dhe mirëmbajtjes do të rriten njësoj sikurse edhe vjetërsia e aseteve.

Menaxhimi i aseteve për shërbimet e ujësjellësit është më kompleks se për shumicën e sektorëve të tjerë për shkak të numrit, llojeve, moshës, gjendjes dhe vendndodhjes së aseteve, madhësisë së investimit të aseteve, si dhe vështirësisë së inspektimit dhe mirëmbajtjes së aseteve të groposura. Ky kompleksitet shpesh shoqërohet nga mungesa e financave, informatave dhe shkathtësive që mund të pengojnë blerjen, mirëmbajtjen, rishikimin dhe zëvendësimin e aseteve në kohën optimale.

Mungesa e investimeve në mirëmbajtjen e aseteve, duke pasur parasysh që shumica e sistemeve të mëdha të ujit dhe të ujërave të ndotura në Kosovë, janë zhvilluar në vitet 1980 dhe më herët, e nga ky fakt nënkuptohet se sot kompanitë e ujit në Kosovë po përballen me shpenzime të mëdha, dhe në rritje, për mirëmbajtje të cilën ata nuk mund ta përballojnë me këtë nivel të menaxhimit.

Në Kosovë sektori i ujit është i rregulluar në nivel qendror nga Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit, mandat i cili i është dhënë nga Ligji Nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit. Ndër përgjegjësitë e tjera, ky Ligj i jep mandat ARRU për të aprovuar ‘Planin e Menaxhimit të Aseteve’. Prandaj ARRU i ka dhënë fokus kësaj çështje, dhe në vazhdimësi ka ndihmuar por edhe kërkuar që kompanitë të hartojnë planet e tyre të menaxhimit të aseteve. Ka hartuar ‘Udhëzuesi për Planifikimin e Menaxhimit të Aseteve’, për ata që janë përfshirë në menaxhimin e aseteve të ujit në Kosovë, kryesisht KRU dhe Rregullatorin e ujit. Për KRU që ato të kenë në dispozicion një mjet ndihmës në procesin e krijimit të menaxhimit të aseteve dhe për Rregullatorin që të ndihmojë në përcaktimin e vendimeve tarifore, të bazuara në planifikime të duhura të menaxhimit të aseteve që ndërlidhen me nivelet e shërbimeve për konsumatorë.

Në Kosovë menaxhimi i aseteve nuk praktikohet aktualisht në mënyrë të planifikuar. Mirëmbajtja e aseteve dhe investimet kapitale në përgjithësi bëhen në baza ad-hoc, duke reaguar ndaj nevojave urgjente, apo dështimeve të sistemit. Si pasojë e kësaj, baza e aseteve vazhdon të përkeqësohet nga viti në vit. Me futjen e një qasje strategjike të menaxhimit të

aseteve, KRU mund të fillojnë të planifikojnë se si të ndryshojnë këtë rënie të vazhdueshme të bazës së aseteve, duke kuptuar se çfarë është e nevojshme dhe se sa mund të kushtojë kjo.

Gjatë aplikimit për procesin tarifar 2018-2020, vetëm tri KRU (Hidromorava, Hidrodrin dhe Gjakova) kanë dorëzuar PMA. Megjithatë, këto plane të dorëzuara nuk janë të mjaftueshëm në nivel të kënaqshëm dhe se pritet ende punë për tu bërë.

Përmes një qasje të disiplinuar ndaj menaxhimit të aseteve mund të përcaktohen nevojat e mësipërme dhe shpenzimet. Analiza lidhur me menaxhimin e aseteve duhet paraqitur në PMA, i cili përdoret për të informuar Biznes Planin dhe Aplikacionin Tarifar për rregullatorin. Në këtë mënyrë ARRU mund të sigurojë që duke mos lënë anash edhe çështjet e përballueshmërisë, që është përcaktimi i një tarife që reflekton koston e vërtetë të mirëmbajtjes së bazës së aseteve për të siguruar nivelet e kërkuara të shërbimit në mënyrën transparente dhe përgjegjshme, si dhe me kosto efektive.

• Menaxhimi i humbjeve të ujit- UPF

Një nga sfidat kryesore që përballen ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë, vazhdon të jenë proporcionet e mëdha të humbjes së ujit në rrjetet shpërndarëse. Nivelet e larta të UPF (58%) dhe që pasqyrojnë vëllime të mëdha të ujit të humbur përmes rrjedhjeve (rreth 90.mil. m³ çdo vit), ujit të trajtuar dhe duke mos u faturuar konsumatorëve, ose të dyja, ndikon seriozisht në qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjeve të ujësjellësve, përmes të ardhurave të humbura dhe rritjeve të kostove operacionale. Kjo është diçka që nga menaxhmenti i kompanive nuk mund të injorohet. **‘Mos harroni se uji më i lirë që do të keni ndonjëherë është uji që tashmë e keni në sistemin tuaj’!**, është një thënie që është dëgjuar shumë herë kur është diskutuar problematika e humbjeve të ujit.

Reduktimi i këtyre humbjeve të ujit është kritik për shfrytëzimin efikas të burimeve, menaxhimin efikas të shërbimeve, rritja e kënaqësisë së konsumatorit dhe shtyrja e investimeve të mëdha të kapitalit në rritjen e kapaciteteve. Në fakt, kostot e përmirësimit të ofrimit të shërbimeve janë shumë më të ulëta kur ndërmerren investimet në reduktimin e humbjeve të ujit, se sa nëpërmjet investimeve në projekte kapitale për të shtuar kapacitetet e furnizimit. ARRU për nevojën e domosdoshme për reduktimin e UPF ka dërguar një ‘Letër të Hapur për shtatë Kompanitë Regjionale të Ujërave,’ në të cilën ka shprehur shqetësimin, duke dhënë njëkohësisht disa propozime për menaxhimin e UPF. Ne kemi mbështetur iniciativën e fundit nga Këshilli Ndërmnistror i Ujërave (KNMU) për hartimin e strategjive nga KRU për reduktimin e humbjeve të ujit, dhe kemi shprehur përkushtimin për të ndihmuar që në kuadër të grupit ndërinstitucional në baza periodike të vlerësojmë përpjekjet dhe progresin e KRU, në përbushjen e objektivave të vendosura në strategjitë e tyre respektive. ARRU ka shqyrtuar me kujdes dhe interes duke konsideruar se për reduktimin e humbjeve të ujit bazike është që KRU të kenë një strategji me një plan të veprimit për reduktimin e UPF, të detajuar me të gjitha komponentët e nevojshme për të pasur progres në këtë sfidë, ashtu siç edhe janë paraqitur në strategjinë e KRU, bashkangjitur edhe planin e veprimit për zvogëlimin e humbjeve komerciale dhe fizike. Në këtë drejtim ARRU i sugjeron KRU që të:

Llogaritën bilancin e UPF-së/ Vlerësimin e humbjeve të ujit sipas Asociacionit Ndërkombëtar të Ujit(IWA) – si bazë për strategjinë e reduktimit të UPF-së. Llogaritja e bilancit të ujit është parakusht për planifikimin dhe zbatimin e strategjisë së duhur për reduktimin e UPF-së, d.m.th, duhet të bëhen llogaritjet e besueshme të bilancit të ujit për të ndihmuar që të kuptohet niveli, shkaqet dhe kostot e UPF-së.

Përcaktojnë ekipin dhe menaxhimin adekuat të aktiviteteve (planit të veprimit) për reduktimin e UPF-së, duke vënë në dispozicion të gjitha resurset në nivel të kompanisë siç janë: teknikët e GIS/Autocad-it, stafi operativ dhe menaxherial, lexuesit e ujëmatësve, punonjësit administrativë, stafi nga departamenti për shërbime të faturimit/ konsumatorëve, si dhe të krijohen lidhjet e mira të komunikimit. Po ashtu është shumë me rëndësi që të gjitha resurset në dispozicion të shpërndahen për një periudhë më të gjatë kohore, pasi që reduktimi i UPF-së është aktivitet afatgjatë.

Zhvillimi i treguesve të performancës, (TP), përfshirë Indeksin e Rrjedhjes së Infrastrukturës (ILI), dhe Nivelin Ekonomik të Rrjedhjes (NERR), të cilat janë indikatorë të rëndësishëm që KRU-të të punojnë me efikasitet dhe krahasueshmëri, komerciale dhe teknike.

Në 'Letër e Hapur për shtatë Kompanitë Regjionale të Ujërave' dërguar para procesit tarifar 2018-2020, për reduktimin e UPF, ARRU ka shprehur se pozicioni i sajë si një rregullator është të mbrojë konsumatorët nga financimi i jo efikasitetit. Prandaj ne besojmë se reduktimi i humbjeve në objektivin e nivelit ekonomik të humbjeve reale është strategjia që siguron vlerën më të mirë për konsumatorët. Ne e pranojmë se sigurimi i financave të nevojshme është kruciale, por edhe pa investime të mëdha kompanitë kanë mundësi të bëjnë më shumë, veçanërisht në reduktimin e humbjeve komerciale. Ne kërkojmë nga KRU-të që përpara shqyrtimit të ardhshëm tarifar (2021-2023), të bëjnë përfshirjen e secilës prej strategjive të kompanive në planet e tyre të biznesit dhe në dobi të strategjive që do të realizohen në rezultatet e tarifave. Sidoqoftë ARRU do të mbështes KRU me të gjitha mekanizmat që i ka në dispozicion, (proceset tarifore, vlerësimin e performancës, vlerësimin dhe përmirësimin e saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave, etj), në drejtim të reduktimit të UPF.

SHTOJCA 1: KUALITETI DHE TË DHËNAT E PERFORMANCËS

a) Kualiteti i të dhënave

Për të prodhuar informacione sa më objektive, të dhënat e raportuara nga KRU përmes formateve raportuese i janë nënshtruar procesit të rregullt vjetor të auditimit/verifikimit nga ana e ARRU, i cili është realizuar gjatë muajit Prill -2018, dhe ka përfshirë të dhënat për vitin 2017.

Saktësia dhe besueshmëria e të dhënave të raportuara është vlerësuar nga ekipi i auditimit bazuar në atë se sa praktiket e KRU për mbajtjen e të dhënave përputhen me një grup të caktuar të kritereve të notimit nga 'Udhëzuesi për avancimin e sistemit të monitorimit në ARRU dhe në KRU'.

Nota (shkalla-norma) e besueshmërisë së të dhënave, shprehur me përqindje, ka shërbyer si input gjatë kalkulimit të vlerësimit final të performancës së KRU. Notat e besueshmërisë (gradimet) janë: 100%; 50% dhe 0%. Përshkrimi i kuptimit të secilës note, për secilën të dhënë, është siguruar nga moduli përkatës i auditimit / inspektimit.

Tabela. 16. Besueshmëria mesatare e të dhënave në KRU

KRU	Të dhënat, jo financiare-ujësjellës dhe shitjet volumetrike	Të dhënat, jo financiare-ujëra të ndotura	Të dhënat financiare, ujësjellës dhe ujëra të ndotura	Mesatarja e përgjithshme e ponderuar
Prishtina	85%	79%	99%	96%
Hidroregjioni Jugor	87%	87%	92%	91%
Hidrodrini	84%	58%	88%	85%
Gjakova	92%	89%	100%	98%
Mitrovica	88%	53%	85%	83%
Bifurkacioni	88%	84%	92%	91%
Hidromorava	88%	95%	100%	98%

Përfundimet e nxjerra nga analiza e sistemit të informacioneve të KRU, në kontekst të mundësisë së gjenerimit të të dhënave të sakta dhe të besueshme, në detaje janë dhënë në raportet e auditimit/verifikimit të të dhënave. Në këtë raport kemi paraqitur një përmbledhje të përgjithshme të të gjeturave nga vlerësimi i cilësisë së të dhënave.

Vlera përfundimtare mesatare e besueshmërisë së të dhënave për KRU është: nga 83% Në KRU 'Mitrovica' deri 98% në KRU 'Gjakova' dhe 'Hidromorava'.

Besueshmëria e të dhënave, jo-financiare për ujësjellës, sillet nga ajo me ulëta prej 84% në KRU 'Hidrodrini' deri tek ajo më larta në KRU 'Gjakova' me 92%, në këtë grup të të dhënave shqetësimet më të mëdha janë tek:

- ✓ Prodhimi i ujit, jo të gjitha burimet e shfrytëzuara aktualisht kanë në përdorim ujëmatës- disa prej tyre edhe janë jo funksional, së këndejmi një sasi e konsiderueshme e ujit të prodhuar vlerësohet përmes metodave alternative. Në asnjë nga KRU nuk ka qenë e mundur të dëshmohet kalibrimi (konformiteti) dhe testimi i ujëmatësve. Përfshirë disa nga Implantet e reja të ndërtuara në KRU (Shkabaj, Albanik, Badovc, Drenas, Shipol, Balincë, Përlepnice, Velekincë, Letnicë.), nuk janë instaluar sistemi SCADA, për monitorimin e prodhimit të ujit. Të dhënat mbahen kryesisht në formë ditari dhe formate të raporteve të cilat nuk janë të verifikueshme dhe plotësisht të besueshme.
- ✓ Shtypja (presioni i ujit), pothuajse në të gjitha KRU, matet në mënyrë të kufizuar. Në KRU 'Mitrovica' presioni monitorohet përmes një numri më të madh manometrash, përmes aplikacionit softuerik (telemetrisë) të presioneve të ujit, megjithëse ka shumë pengesa gjatë monitorimit- softueri apo edhe manometrat janë jo funksional. Në KRU

'Gjakova, përcjellja e presioneve bëhet në mënyrë manuale në manometrat e vendosura në stacionet e pompave. Në përgjithësi në asnjë nga KRU nuk janë vendosur zonat për menaxhimin e shtypjeve, si dhe nuk është i instaluar sistemi SCADA.

- ✓ Humbjet e ujit, KRU nuk zbatojnë ndonjë modul për të llogaritur Bilancin Ujorë. Të dhënat për humbjet e ujit janë të vlerësuara sipas proporcioneve të ndryshme.
- ✓ Gjatësia totale e rrjetit të ujësjellësit-kanalizimit, ende nuk është përditësuar në tërsi në SIG. Në përgjithësi, mbledhja dhe mirëmbajtja e të dhënave për gjatësinë e rrjeteve është dobët, përjashtuar KRU (Hidrodrini, Gjakova, Hidromorava, Hidroregjioni Jugor), të cilat kanë përditësuar një pjesë të madhe rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit.
- ✓ Defektet / plasjet në sistemet e ujësjellësi dhe bllokimet/dështimet e kanalizimeve mbahen në Excel në formate të raporteve mujore, si dhe në formë të lëndëve. Në disa prej KRU, ekzistojnë aplikacionet softuerik përkatëse (CRM) për regjistrimin e defekteve, dhe bllokimeve por të njëjtat nuk janë të azhuruara.
- ✓ Të dhënat për konsumatorët në shërbimin e ujësjellësit mbahen në sistemin për menaxhimin e informacioneve komerciale në modulin e faturimit
- ✓ Ankesat për shërbimin e ujësjellësit mbahen në formate Exceli, gjegjësisht raporte për regjistrimin e ankesave. Në disa KRU (Gjakova, Hidromorava dhe Bifurkacioni), ekzistojnë modulet aplikative ku ankesat janë të përditësuara dhe azhuruara me rregull.

Besueshmëria e të dhënave jo financiare-ujëra të ndotura, sillet nga 53% në KRU Mitrovica', deri me 95% në 'Hidromorava'.

- ✓ Probleme të theksuara, janë paraqitur tek të dhënat për bllokimet dhe dështimet e kanalizimi, ankesat e konsumatorëve. Këto të dhëna shumica e kompanive i mbajnë në kopje të fortë apo edhe në formate elektronike (excel). Disa kompani kanë, module softuerike adekuate për menaxhimin e informacioneve të konsumatorëve (CRM), por nuk i kanë përditësuar.
- ✓ Të dhënat për konsumatorët kryesisht, janë të besueshme dhe ato mbahen në module të faturimit të programeve ekzistuese aktuale.

Besueshmëria e të dhënave financiare, sillet nga 85% në KRU "Mitrovica" deri në besueshmërinë e plotë prej 100% të KRU "Hidromorava" dhe KRU "Gjakova".

Kompanitë kanë në përdorim programe të avancuara për mbajtjen e informacioneve financiare (Navision, Alfa Business, Asseco, Pronet, Rikont Informatika) dhe të dhënat varësisht prej natyrës së tyre mbahen në module përkatëse (moduli i kontabilitetit dhe faturimit).

- ✓ **Të ardhurat nga shitjet, Shpenzimet operative, Shpenzimet kapitale për ujësjellës dhe për ujëra të ndotura**, në përgjithësi mbahen në Modul të Kontabilitetit/Faturimit. Shumica e programeve mundësojnë ndarjen e shpenzimeve operative dhe kapitale edhe sipas kosto qendrave duke u bazuar në kërkesat rregullatore, por me disa ndërhyrje të vogla pastaj barten në Excel formate.
- ✓ **Zhvlerësimi sipas kostos aktuale dhe Baza rregullatore e aseteve për ujësjellës dhe ujëra të ndotura**, realizohet në bazë të aplikacionit të integruar në Excel, të përvetësuar kohë me parë nga ARR. Meqenëse sistemet aktuale të menaxhimit të informacioneve financiare, nuk ofrojnë mundësinë e zhvlerësimit të aseteve sipas kërkesave rregullatore.

b) Rekomandime të përgjithshme –përmirësimi i besueshmërisë së të dhënave

Me qëllim të avancimit të sistemit të mbajtjes, menaxhimit dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara, ashtu siç tregohet edhe në 'Udhëzuesin për avancimin e sistemit të monitorimit në ARR dhe KRU'. ARR, rekomandon për:

- ✓ **Avancimin e sistemit të regjistrimit, ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave, përmes një sistemi të integruar elektronik të monitorimi.**
- ✓ **Instalimin e ujëmatësve në të gjitha vendburimet e prodhimit të ujit, duke zëvendësuar dhe testuar ujëmatësit e vjetërsuar / të dëmtuar për të prodhuar informacione të sakta dhe të besueshme,**
- ✓ **Vendosjen e sistemit të kontrolles dhe mbikëqyrjes SCADA, për kontrollin e ujit të trajtuar dhe kontrollin e ujit të shpërndarë në tërë sistemin e trajtimit dhe shpërndarjes së ujit në tërë zonën e shërbimit të kompanisë,**
- ✓ **Vendosjen e programit të menaxhimit të presioneve, me pajisje të mjaftueshme (manometra), dhe instalimin e sistemit të mbikëqyrjes, kontrollit dhe matjes (SCADA), për të matur dhe siguruar të dhëna të besueshme për tërë zonën e furnizimit dhe për rrjetin shpërndarës të ujit.**
- ✓ **Vazhdimin me përdorimin/përditësimin e sistemit informativ gjeografik- SIG për të ruajtur informacionet e sakta të gjatësive të rrjetave të ujësjellësit dhe kanalizimit, defekteve/riparimeve.**
- ✓ **Llogaritjen e bilancit të ujit sipas Modullit të IWA, për të definuar, menaxhuar dhe reduktuar UPF, si dhe duke raportuar të dhënat nga ky modul,**
- ✓ **Përditësimin e sistemit të informacioneve komerciale, dhe databazës-moduleve, me të dhënat për: faturimin, ankesat e konsumatorëve, leximit të ujëmatësve, kontratave, etj, dhe duke lidhur këtë sistem me Sistemin Informativ Gjeografik (SIG),**
- ✓ **Angazhuar staf, profesional të mjaftueshëm dhe mirë të trajnuar për të punuar me aplikacionet softuerike ekzistuese dhe me ato të avancuara, që në një të ardhme shumë të afërt duhet siguruar.**

c) Të dhënat e detajuara të performancës

Të dhënat dhe treguesit e performancës në përdorim plotësojnë të gjitha kërkesat e matjes së mirë dhe efektive të performancës për nevoja dhe qëllime të proceseve Rregullatore, institucioneve vendore me përgjegjësi vendimmarrëse në këtë sektor, informacione të vlefshme për donatorët, konsumatorët, ofruesit e shërbimeve dhe publikun e gjerë. Për nevoja të raportit kemi shfrytëzuar edhe të dhëna tjera të ofruara dhe të publikuara nga institucionet përgjegjëse siç është rasti me të dhënat e raportuara nga IKSHPK (kualiteti i ujit) apo Agjencioni i Statistikave të Kosovës (shkalla e inflacionit, statistikën e popullatës dhe ekonomive familjare).

Statistikat e detajuara të performancës së shtatë KRU janë të paraqitura në tabelat në vijim. Informatat e prezantuara janë të bazuara në dorëzimin e rregullt të raporteve në ARRU.

- ✓ të dhënat në lidhje me statistikën e popullsisë, numrin e konsumatorëve, gjatësinë e gypave, etj. nuk janë të dhëna të fund vitit, por janë mesatare të vlerësuara të vitit.
- ✓ të dhënat financiare të shprehura në EUR, janë të përshtatura në nivelet e çmimeve të mesit të vitit 2014 (viti kur edhe janë përcaktuar tarifat tri vjeçare 2015-2017) e në përputhje me statistikën e publikuara të inflacionit për të mundësuar krahasimet e duhura nga viti në vit.
- ✓ të dhënat financiare janë raportuar në përputhje me “Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR)”, e në veçanti:
- ✓ përcaktimi i vlerës së aseteve është bërë sipas Bazës Rregullatore të Aseteve,
- ✓ mirëmbajtja kapitale është definuar si kombinim i ripërtëritjeve infrastrukturore dhe zhvlerësimit sipas kostos aktuale të aseteve jo-infrastrukturore,
- ✓ provizionimi i borxheve të këqija (shlyerja) janë të definuara si shuma të të ardhurave të pa-arkëtuara nga viti paraprak.

KRU Prishtina (Prishtinë)

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2016	2017
W - Furnizimi me ujë						
Jo-financiar (teknik)						
Standardët e shërbimit	Cilësia	Cilësia e ujit (bakteriologjike)	W.1.A.01	% e tes. të kaluara	99.3%	99.9%
		Cilësia e ujit (fizike dhe kimike)	W.1.A.02	% e tes. të kaluara	92.5%	99.1%
	Shtypja	Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.03	Nr	122	81
		Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.04	% e pronave	0.12%	0.07%
	Besueshmëria	Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.05	Nr	28,707	85,310
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.06	% e pronave	27%	77%
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.07	Nr	55,361	16,676
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.08	% e pronave	53%	15%
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.09	Nr	20,694	8,926
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.10	% e pronave	20%	8%
Shërbyeshmëria infrastrukture	Uji i pa-faturuar	Uji i pa-faturuar (totali)	W.1.B.01	m3 në vit	23,630,379	29,757,221
		Uji i pa-faturuar (për kycje)	W.1.B.02	litra për kons. për ditë	548	652
		Uji i pa-faturuar (për kycje) – i rregulluar	W.1.B.03	litra për kons. për ditë	620	679
		Uji i pa-faturuar (si përqindje e prodhimit)	W.1.B.04	% e prodhimit	53%	57%
	Plasartjet e gypave	Frekuenca e plasartjeve në rjetin e gypave	W.1.B.05	plasartjet për muaj	112	114
		Plasartjet e gypave të rjetit për 100 km të gypit	W.1.B.06	Nr / 100 km	75	72
Jo-financiar (komercial)						
Shtirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	W.2.A.01	Nr	104,762	110,912
		Shtirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	W.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	112%	117%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	W.2.A.03	Nr	7,796	4,504
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	W.2.A.04	Nr	760	727
Matja e ujit	Norma me ujëmatës	Konsumatorët shtëpiak më ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak	W.2.B.01	% totali i kons. shtëpiak	97%	98%
		Konsumatorët kom & inst me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve kom & inst	W.2.B.02	% kom & inst	100%	100%
	Ujëmatësit e instaluar	Ujëmatësit e instaluar (shtëpiak)	W.2.B.03	Nr	430	570
		Ujëmatësit e instaluar (kom & inst)	W.2.B.04	Nr	21	24
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranuara (teknike)	W.2.C.01	Nr	3,001	3,607
		Ankesat e pranuara (komerciale)	W.2.C.02	Nr	4,342	4,239
Financiar						
Shitjet	Volumet	Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës)	W.3.A.01	m3	15,991,355	16,927,981
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	80%	86%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës)	W.3.A.03	m3	719,651	762,413
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	783%	N/A
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës)	W.3.A.05	% e vlerësimit sipas planit	4,486,130	4,621,711
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.06	% e vlerësimit sipas planit	90%	77%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës)	W.3.A.07	% e vlerësimit sipas planit	18,683	18,057
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.08	% e vlerësimit sipas planit	0%	N/A%
	Vlerat	Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak	W.3.A.09	EUR	7,904,831	8,244,302
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.10	% e vlerësimit sipas planit	89%	91%
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst	W.3.A.11	EUR	4,509,197	4,546,996
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.12	% e vlerësimit sipas planit	95%	79%
Kostoja për njësi	Prodhimi	Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.01	EUR/m3	0.055	0.049
		Kostoja totale për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.02	EUR/m3	0.059	0.055
	Kostoja totale	Kostoja për njësi të ujit të shitur	W.3.B.03	EUR/m3	0.421	0.426
		Kostoja për njësi të ujit të shitur dhe të paguar	W.3.B.04	EUR/m3	N/A	N/A
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtja kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	W.3.C.01	EUR	2,924	0
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	W.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	0%	0%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	W.3.C.03	% e BRA	0%	0%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	W.3.C.04	EUR	609,422	40,837,387
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	W.3.C.05	% e vlerësimit sinas nlanit	9.1%	11391%

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2016	2017
K- Ujërat e zeza						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	S.1.A.01	% e tes. të kaluara	N/A	N/A
Besueshmëria	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	S.1.B.01	Nr	3,315	3,321
		Vërshimet e rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.B.02	Nr për 100 km	463	304
Shërbyeshmëria	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	S.1.C.01	Nr	0	0
		Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.C.02	Nr për 100 km	0	0
	Mbingarkimet e implantit për trajtimin e ujërave të zeza	Mbingarkimet e implantit për trajtimin e ujërave të zeza	S.1.C.03	Nr	N/A	N/A
Jo-financiar (komercial)						
Shtirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	S.2.A.01	Nr	89,782	95,695
		Shtirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	S.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	96%	101%
		Konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza	S.2.A.03	Nr	0	0
		Shtirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza në raport me totalin)	S.2.A.04	% totali i kons. shtëpiak	0%	0%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	S.2.A.05	Nr	7,347	4,480
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	S.2.A.06	Nr	742	661
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranuar (teknike)	S.2.B.01	Nr	3,627	3,551
		Ankesat e pranuar (komerciale)	S.2.B.02	Nr	0	0
Financiar						
Shitjet	Vlerat	Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak	S.3.A.01	EUR	725,452	758,772
		Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	90%	93%
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst	S.3.A.03	EUR	489,453	484,184
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	94%	76%
Kostoja për njësi	Trajtimi dhe shkarkimi	Kosto operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për m³	S.3.B.01	EUR/m3	N/A	N/A
		Totali i koston të trajtimit dhe shkarkimit për m³	S.3.B.02	EUR/m3	N/A	N/A
		Kostoja operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.03	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.04	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
	Grumbullimi	Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.05	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.06	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.07	EUR/ kons. shtëpiak	1.26	1.32
		Totali i koston për shërbime të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.08	EUR/ kons. shtëpiak	1.35	1.45
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtje kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	S.3.C.01	EUR	0	0
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	S.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	0%	0%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	S.3.C.03	% e BRA	0%	0%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	S.3.C.04	EUR	138,528	219,349
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	S.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	237%	1,874%
F – Financiar						
Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave						
Shitjet		Totali i shitjeve	F.1.A.01	EUR	13,628,933	14,034,254
		Totali i shitjeve në raport me planin	F.1.A.02	% e vlerësimit sipas planit	91%	86%
Eficienca e arkëtimit		Totali i të ardhurave të arkëtuara	F.1.B.01	EUR	12,590,030	12,348,231
		Totali i tejkalimit të arkëtimit të të ardhurave	F.1.B.02	EUR	621,321	-1,581,093
		Totali i tejkalimit të arkëtimit të të ardhurave (relative)	F.1.B.03	% e vlerësimit sipas planit	105%	89%
		Totali i të ardhurave të shlyera (faturimi-inkasimi i vitit paraprak)	F.1.B.04	EUR	3,218,596	1,038,903
		Totali i të ardhurave të shlyera në raport me totalin e faturimit	F.1.B.05	% e faturimit	24%	7%
		Arkëtimi i të ardhurave në raport me faturimin	F.1.B.06	% e faturimit	92%	88%
		Llogaritë e arkëtueshme	F.1.B.07	EUR	N/A	N/A
		Llogaritë e arkëtueshme në raport me qarkullimin	F.1.B.08	Qarkullimi në ditë	N/A	N/A
Vlerat kyçe financiare dhe normat						
Vlerat		Rjedha e lirë e parasë së gatshme	F.2.A.01	EUR	N/A	N/A
Normat	Kthimet	Kthimi në kapital	F.2.B.01	%	5,71%	5,92%
		Kosto e borxhit	F.2.B.02	%	N/A	N/A
		Leva financiare	F.2.B.03	normë	N/A	N/A
	Normat	Mbulesa e interesit të parasë së gatshme	F.2.B.04	normë	N/A	N/A
		Fondet nga operacionet/borxhi	F.2.B.05	normë	N/A	N/A
		Norma e mbulimit të shërbimit të borxhit	F.2.B.06	normë	N/A	N/A

KRU Hidroregjioni Jugor (Prizren)

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2016	2017
W - Furnizimi me ujë						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia	Cilësia e ujit (bakteriologjike)	W.1.A.01	% e tes. të kaluara	98.5%	100%
		Cilësia e ujit (fizike dhe kimike)	W.1.A.02	% e tes. të kaluara	94%	100%
	Shtypja	Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.03	Nr	0	0
		Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.04	% e pronave	0%	0%
	Besueshmëria	Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.05	Nr	37,663	39,287
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.06	% e pronave	99%	99%
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.07	Nr	100	200
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.08	% e pronave	0%	1%
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.09	Nr	200	0
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.10	% e pronave	1%	0%
Shërbyeshmëria infrastrukture	Uji i pa-faturuar	Uji i pa-faturuar (totali)	W.1.B.01	m3 në vit	10,025,665	10,115,569
		Uji i pa-faturuar (për kycje)	W.1.B.02	litra për kons. për ditë	629	612
		Uji i pa-faturuar (për kycje) – i regulluar	W.1.B.03	litra për kons. për ditë	630	612
		Uji i pa-faturuar (si përqindje e prodhimit)	W.1.B.04	% e prodhimit	58%	58%
	Plasartitjet e gypave	Frekuenca e plasartitjeve në rrjetin e gypave	W.1.B.05	plasartitjet për muaj	196	257
		Plasartitjet e gypave të rrjetit për 100 km të gypit	W.1.B.06	Nr / 100 km	462	605
Jo-financiar (komercial)						
Shtirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	W.2.A.01	Nr	37,964	39,487
		Shtirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	W.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	69%	70%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	W.2.A.03	Nr	1,781	1,266
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	W.2.A.04	Nr	91	98
Matja e ujit	Norma me ujëmatës	Konsumatorët shtëpiak më ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak	W.2.B.01	% totali i kons. shtëpiak	94%	95%
		Konsumatorët kom & inst me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve kom & inst	W.2.B.02	% kom & inst	97%	97%
	Ujëmatësit e instaluar	Ujëmatësit e instaluar (shtëpiak)	W.2.B.03	Nr	1,862	543
		Ujëmatësit e instaluar (kom & inst)	W.2.B.04	Nr	199	66
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranura (teknike)	W.2.C.01	Nr	1,420	1,417
		Ankesat e pranura (komerciale)	W.2.C.02	Nr	808	1,048
Financiare						
Shitjet	Volumet	Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës)	W.3.A.01	m3	5,379,416	5,501,868
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	71%	75%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës)	W.3.A.03	m3	795,034	679,994
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	271%	N/A
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës)	W.3.A.05	% e vlerësimit sipas planit	1,055,358	1,085,840
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.06	% e vlerësimit sipas planit	66%	67%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës)	W.3.A.07	% e vlerësimit sipas planit	115,740	99,154
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.08	% e vlerësimit sipas planit	2,391%	N/A
	Vlerat	Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak	W.3.A.09	EUR	2,720,157	2,695,988
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.10	% e vlerësimit sipas planit	84%	83%
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst	W.3.A.11	EUR	1,029,341	1,023,657
		Vlera e ujit të shitur për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.12	% e vlerësimit sipas planit	81%	77%
Kostoja për njësi	Prodhimi	Kostoja operative për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.01	EUR/m3	0.083	0.088
		Kostoja totale për njësi të ujit të prodhuar	W.3.B.02	EUR/m3	0.086	0.094
	Kostoja totale	Kostoja për njësi të ujit të shitur	W.3.B.03	EUR/m3	0.402	0.437
		Kostoja për njësi të ujit të shitur dhe të paguar	W.3.B.04	EUR/m3	N/A	N/A
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtja kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	W.3.C.01	EUR	24,241	59,293
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	W.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	0%	2%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	W.3.C.03	% e BRA	0.3%	0.8%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	W.3.C.04	EUR	1,158,566	159,221
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	W.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	13%	4.1%

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2016	2017
K- Ujërat e zeza						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara	S.1.A.01	% e tes. të kaluara	N/A	N/A
Besueshmëria	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	Vërshimet e rrjetit të kanalizimit	S.1.B.01	Nr	1,036	1,215
		Vërshimet e rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.B.02	Nr për 100 km	384	450
Shërbyeshmëria	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit	S.1.C.01	Nr	59	77
		Prishjet/kolapsi i rrjetit të kanalizimit për 100 km të gypit	S.1.C.02	Nr për 100 km	21.85	28.52
	Mbingarkimet e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza	S.1.C.03	Nr	N/A	N/A	
Jo-financiar (komercial)						
Shtirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	S.2.A.01	Nr	32,860	34,747
		Shtirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	S.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	59%	62%
		Konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza	S.2.A.03	Nr	0	0
		Shtirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer me trajtimin e ujërave të zeza në raport me totalin)	S.2.A.04	% totali i kons. shtëpiak	0%	0%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	S.2.A.05	Nr	2,010	1,763
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	S.2.A.06	Nr	78	127
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranua (teknike)	S.2.B.01	Nr	63	558
		Ankesat e pranua (komerciale)	S.2.B.02	Nr	24	47
Financiar						
Shitjet	Vlerat	Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak	S.3.A.01	EUR	323,971	324,659
		Vlera e shitjeve për konsumatorët shtëpiak në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	93%	95.5%
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst	S.3.A.03	EUR	127,181	126,804
		Vlera e shitjeve për konsumatorët kom & inst në raport me vlerësimet sipas planit	S.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	76%	72%
Kostoja për njësi	Trajtimi dhe shkarkimi	Kosto operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për m³	S.3.B.01	EUR/m3	N/A	N/A
		Totali i koston të trajtimit dhe shkarkimit për m³	S.3.B.02	EUR/m3	N/A	N/A
		Kostoja operative për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.03	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të trajtimit dhe shkarkimit për konsumator shtëpiak	S.3.B.04	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
	Grumbullimi	Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.05	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Totali i koston për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.06	EUR/ kons. shtëpiak	N/A	N/A
		Kosto operative për njësi të grumbullimit të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.07	EUR/ kons. shtëpiak	10.34	10.64
		Totali i koston për shërbime të ujërave të zeza për konsumator shtëpiak	S.3.B.08	EUR/ kons. shtëpiak	10.39	10.69
Shpenzimet kapitale	Mirëmbajtje kapitale	Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale	S.3.C.01	EUR	1,142	0
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me planin	S.3.C.02	% e vlerësimit sipas planit	0%	0%
		Totali i shpenzimeve për mirëmbajtje kapitale në raport me BRA	S.3.C.03	% e BRA	0%	0%
	Rritja kapitale	Totali i shpenzimeve për rritje kapitale	S.3.C.04	EUR	1,648	8,102
		Totali i shpenzimeve për rritje kapitale në raport me planin	S.3.C.05	% e vlerësimit sipas planit	0%	0.12%
F – Financiar						
Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave						
Shitjet		Totali i shitjeve	F.1.A.01	EUR	4,200,651	4,171,108
		Totali i shitjeve në raport me planin	F.1.A.02	% e vlerësimit sipas planit	83%	82%
Eficienca e arkëtimit		Totali i të ardhurave të arkëtuara	F.1.B.01	EUR	3,666,487	3,946,679
		Totali i tejkalimit të arkëtimit të të ardhurave	F.1.B.02	EUR	-364,058	-217,809
		Totali i tejkalimit të arkëtimit të të ardhurave (relative)	F.1.B.03	% e vlerësimit sipas planit	91%	95%
		Totali i të ardhurave të shlyera	F.1.B.04	EUR	1,089,703	534,164
		Totali i të ardhurave të shlyera në raport me totalin e faturimit	F.1.B.05	% e faturimit	26%	13%
		Arkëtimi i të ardhurave në raport me faturimin	F.1.B.06	% e faturimit	87%	95%
		Llogaritë e arkëtueshme	F.1.B.07	EUR	N/A	N/A
		Llogaritë e arkëtueshme në raport me qarkullimin	F.1.B.08	Qarkullimi në ditë	N/A	N/A
Vlerat kyçe financiare dhe normat						
Vlerat		Rjedha e lirë e parasë së gatshme	F.2.A.01	EUR	N/A	N/A
Normat	Kthimet	Kthimi në kapital	F.2.B.01	%	-1.76%	6.55%
		Kosto e borxhit	F.2.B.02	%	N/A	N/A
		Leva financiare	F.2.B.03	normë	N/A	N/A
	Normat	Mbulesa e interes të parasë së gatshme	F.2.B.04	normë	N/A	N/A
		Fondet nga operacionet/borxhi	F.2.B.05	normë	N/A	N/A
		Norma e mbulimit të shërbimit të borxhit	F.2.B.06	normë	N/A	N/A

KRU Hidrodrini (Pejë)

Kategoria / nën-kategoria	Nën-nën-kategoria	Treguesi	Ref	Njësia	2016	2017
W- Furnizimi me ujë						
Jo-financiar (teknik)						
Standardet e shërbimit	Cilësia	Cilësia e ujit (bakteriologjike)	W.1.A.01	% e tes. të kaluara	98.9%	100%
		Cilësia e ujit (fizike dhe kimike)	W.1.A.02	% e tes. të kaluara	94%	100%
	Shtypja	Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.03	Nr	0	0
		Pronat e ndikuara nga shtypja e ulët	W.1.A.04	% e pronave	0%	0%
	Besueshmëria	Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.05	Nr	39,107	40,282
		Pronat që furnizohen 24 orë me ujë	W.1.A.06	% e pronave	100%	100%
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.07	Nr	14	0
		Pronat që furnizohen 18-24 orë me ujë	W.1.A.08	% e pronave	0%	0%
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.09	Nr	0	0
		Pronat që furnizohen më pak se 18 orë me ujë	W.1.A.10	% e pronave	0%	0%
Shërbyeshmëria infrastrukture	Uji i pa-faturuar	Uji i pa-faturuar (totali)	W.1.B.01	m3 për ditë	16,556,768	16,390,162
		Uji i pa-faturuar (për kycje)	W.1.B.02	litra për kons. për ditë	1,026	990
		Uji i pa-faturuar (për kycje) – i rregulluar	W.1.B.03	litra për kons. për ditë	1,026	990
		Uji i pa-faturuar (si përqindje e prodhimit)	W.1.B.04	% e prodhimit	65%	64%
	Plasartjet e gypave	Frekuenca e plasartjeve në rrjetin e gypave	W.1.B.05	plasartjet për muaj	158	203
		Plasartjet e gypave të rrjetit për 100 km të gypit	W.1.B.06	Nr / 100 km	239	248
		Jo-financiar (komercial)				
Shtirja me shërbime	Shtëpiak	Konsumatorët shtëpiak të shërbyer	W.2.A.01	Nr	39,121	40,282
		Shtirja (konsumatorët shtëpiak të shërbyer në raport me totalin)	W.2.A.02	% totali i kons. shtëpiak	99%	101%
	Kycjet e reja	Kycjet e reja (konsumatorët shtëpiak)	W.2.A.03	Nr	1,756	566
		Kycjet e reja (konsumatorët komercial dhe institucional)	W.2.A.04	Nr	252	-278
Matja e ujit	Norma me ujëmatës	Konsumatorët shtëpiak më ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve shtëpiak	W.2.B.01	% totali i kons. shtëpiak	95%	96%
		Konsumatorët kom & inst me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve kom & inst	W.2.B.02	% kom & inst	95%	97%
	Ujëmatësit e instaluar	Ujëmatësit e instaluar (shtëpiak)	W.2.B.03	Nr	2,970	1,540
		Ujëmatësit e instaluar (kom & inst)	W.2.B.04	Nr	423	0
Ankesat	Ankesat	Ankesat e pranuar (teknike)	W.2.C.01	Nr	1,309	1,309
		Ankesat e pranuar (komerciale)	W.2.C.02	Nr	85	85
Financiar						
Shitjet	Volumet	Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës)	W.3.A.01	m3	7,048,032	7,118,989
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.02	% e vlerësimit sipas planit	88%	85%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës)	W.3.A.03	m3	178,891	170,025
		Volumi i shitjeve për konsumatorët shtëpiak (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.04	% e vlerësimit sipas planit	90%	N/A
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës)	W.3.A.05	% e vlerësimit sipas planit	1,772,266	1,967,781
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (me ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.06	% e vlerësimit sipas planit	100%	109%
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës)	W.3.A.07	% e vlerësimit sipas planit	7,769	13,000
		Volumi i shitjeve për konsumatorët kom & inst (pa ujëmatës) në raport me vlerësimet sipas planit	W.3.A.08	% e vlerësimit sipas planit	78%	N/A
	Vlerat	Vlera e ujit të shitur për konsumatorët shtëpiak	W.3.A.09	EUR	2,218,711	2,184,746
